

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
VITI 2022

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	30.12.2021	<p>1. Cili do të jetë roli i Ministrisë së Bujqësisë në zbatimin e planit për emigrantët që investojnë në agroturizëm?</p> <p>2. Kur pritet të nisë zbatimi i planit për mbështetjen e emigrantëve?</p> <p>3. Si është menduar të bëhet zbatimi i tij?</p> <p>4. A ka pasur kërkesa nga emigrantët për të përfituar?</p>	19.1.2022	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është në proces të hartimit të bazës ligjore për mbështetjen financiare për vitin 2022.	Përgjigja është dhënë e plotë	0
2	10.1.2022	<p>1. Kur do të nisë zbatimi i planit për mbështetjen e emigrantëve që investojnë në argoturizëm?</p> <p>2. Kush përfiton nga ky plan, pra ka kritere për të qenë përfitues?</p> <p>3. Si është menduar të bëhet zbatimi i tij?</p>	19.1.2022	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është në proces të hartimit të bazës ligjore për mbështetjen financiare për vitin 2022.	Përgjigja është dhënë e plotë	0

		<p>4. A ka një limit, sa persona mund të përfitojnë?</p> <p>5. A ka pasur interes nga emigrantët për të përfituar nga plani?</p>				
3	10.1.2022	<p>1. A janë bërë kontrole nga veterinerët e Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë në thertore dhe tregjet e licencuara të kafshëve? (Ju lutem specifikoni periudhën)</p> <p>2. Ku janë shtrirë këto kontrole kryesisht?</p> <p>3. Sa veterinerë janë angazhuar në gjithë vendin për kontrollet?</p> <p>4. Çfarë problemesh janë evidentuar nga kontrollet e bëra, si në thertore ashtu edhe në tregjet e kafshëve?</p>	14.1.2022	<p>Referuar Kreut II të VKM-së Nr. 475, datë 30.7.2021 “Për bashkëpunimin e njësisve të vetëqeverisjes vendore me shërbimin veterinar”, njësitë e vetëqeverisjes vendore, në bashkëpunim me AKVMB-në përcaktojnë dhe bëjnë publike zonat e përshtatshme për ngritjen dhe funksionimin e tregjeve të kafshëve të gjalla dhe thertoreve në territorin që ato mbulojnë. VKM-ja Nr. 683, datë 2.9.2020 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve”, në Kreun II, përcakton se AKVMB-ja, ndër të tjera, ka përgjegjësi të organizojë punën për kryerjen e kontrolleve zyrtare dhe veprimtaritë e tjera veterinare.</p>	Deleguar	0

				Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” kërkesa i është dërguar AKVMB-së në adresën danjel.sovjani@akvmb.gov.al .		
4	13.1.2022	<p>1. A keni ofruar mbështetje financiare për organizatat e shoqërisë civile gjatë vitit kalendarik 2021?</p> <p>2. Nëse keni ofruar mbështetje financiare, cila ka qenë forma e mbështetjes (grant, kontrata shërbimi, prokurim publik/tenderim, etj.)?</p> <p>3. Sa organizata të shoqërisë civile kanë aplikuar për mbështetje financiare gjatë vitit 2021? Specifiko sipas formës nëse ka patur më shumë se një formë.</p> <p>4. Sa është numri i organizatave që kanë përfituar nga kjo mbështetje? Specifiko sipas formës nëse ka patur më shumë se një formë.</p>	11.2.2022	<ul style="list-style-type: none"> Nga ana e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është ofruar mbështetje financiare për organizatat jofitimprurëse nëpërmjet Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, institucion në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Forma e mbështetjes ka qenë grant. Nga ky fond kanë përfituar 37 (tridhjetë e shtatë) shoqata. Shuma e përfitimit për organizatë jofitimprurëse ka qenë 1,886,821 lekë; 904,647 lekë; 3,602,641 lekë; 4,010,300 lekë; 5,563,420 lekë; 1,118,862 lekë; 2,385,313 lekë; 781,952 lekë; 5,313,874 lekë; 	Përgjigja është dhënë e plotë	0

		<p>5. Cila ka qenë shuma e përfitimit për organizatë dhe në total? Specifiko sipas formës nëse ka patur më shumë se një formë.</p> <p>6. Keni ofruar mbështetje jofinanciare për organizatat e shoqërisë civile gjatë vitit 2021? Cila është baza ligjore/rregullatore që rregullon këtë mbështetje?</p> <p>7. Nëse po, sa organizata kanë përfituar nga mbështetja jofinanciare e ofruar? Cili ka qenë lloji i mbështetjes jofinanciare të ofruar?</p> <p>8. Sa është numri i konsultimeve publike të realizuara nga institucioni juaj gjatë vitit kalendarik 2021?</p> <p>9. A ka institucioni juaj Koordinator për Njoftimin dhe Konsultimin Publik?</p> <p>10. A ka institucioni juaj koordinator për shoqërinë civile?</p> <p>11. Sa organizata jofitimprurëse kanë marrë</p>		<p>5,028,104 lekë; 5,800,282 lekë; 5,296,882 lekë; 4,530,632 lekë; 3,108,986 lekë; 4,343,816 lekë; 5,004,130 lekë; 5,838,664 lekë; 5,924,581 lekë; 5,494,288 lekë; 5,086,127 lekë; 3,922,739 lekë; 3,997,550 lekë; 1,350,251 lekë; 1,697,594 lekë; 4,100,229 lekë; 2,945,932 lekë; 3,257,552 lekë; 1,543,947 lekë; 399,806 lekë; 513,046 lekë; 1,118,074 lekë; 1,449,543 lekë; 1,094,945 lekë; 934,416 lekë; 1,108,855 lekë; 1,385,747 lekë; 476,960 lekë.</p> <p>• Shuma e përfitimit në total ka qenë: 112,321,508 lekë.</p> <p>Për vitin 2021 drejtoritë teknike kanë sqaruar se ministria nuk ka ofruar mbështetje jofinanciare për organizatat e shoqërisë civile.</p> <p>Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nuk ka koordinator për shoqërinë civile, pra për subjekte të caktuara, por për fusha të</p>		
--	--	--	--	---	--	--

		<p>pjesë në këto konsultime publike?</p> <p>12. Sa përqind (%) e projektligjeve/akteve nënligjore të hartuara nga institucioni juaj janë si rezultat i konsultimeve me OJF-të?</p> <p>13. A janë përfshirë përfaqësues të organizatave jofitimprurëse në organe këshillimore të institucionit tuaj?</p> <p>14. Nëse po, cila është rregullorja kuadri rregullues që mundëson përfshirjen e organizatave jofitimprurëse në këto organe? Ju lutem, bashkëngjisni dokumentin apo linkun.</p> <p>15. A janë përfshirë organizatat jofitimprurëse në grupet e punës të ngritura të institucionit tuaj?</p> <p>16. Nëse po, cila është rregullorja/kuadri rregullues që mundëson përfshirjen e organizatave jofitimprurëse në këto organe. Ju lutem</p>		<p>caktuara, si p.sh.: për të drejtën e informimit, për njoftimin dhe konsultimin publik etj.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në Kreun IV të VKM-së Nr. 708, datë 9.9.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit” (https://aku.gov.al/wp-content/uploads/2020/09/vendim-2020-09-09-1-1.pdf), përcaktohet mënyra e funksionimit dhe organizimit të Bordit të AKU-së, i cili përmban në strukturën e tij vendimmarrëse përfaqësues nga shkenca, shoqatat e konsumatorëve dhe agrobiznesit, shoqatat e bashkive, përfaqësues të medias, shëndetit publik etj. (https://bujqesia.gov.al/rithemlimi-i-bordit-te-autoritetit-kombetar-te-ushqimit/). • Më datë 29.4.2021 Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka zhvilluar takimin konsultativ 		
--	--	---	--	---	--	--

		<p>bashkëngjisni dokumentin apo linkun.</p> <p>17. Nëse po, cilat janë këto organe këshillimore dhe sa përfaqësues nga organizatat jofitimprurëse janë të përfshira në to?</p> <p>18. A janë të përfshirë organizatat jofitimprurëse në grupe pune ndërsektoriale të ngritura në institucionin tuaj?</p> <p>19. Nëse po, cilat janë këto grupe dhe sa përfaqësues nga organizatat jofitimprurëse janë të përfshira në to?</p>		<p>me përfaqësues të shoqërisë civile, grupet e interesit për Programin Buxhetor Afatmesëm 2022 – 2024 (https://bujqesia.gov.al/ministria-e-bujqesise-dhe-zhvillimit-rural-zhvillon-takimin-konsultativ-me-shoqerine-civile-grupet-e-interesit-per-pba-2022-2024/).</p> <p>Organizatat jofitimprurëse nuk janë përfshirë në grupet e punës të ngritura pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.</p>		
5	17.1.2022	<p>Informacion mbi procedurën për regjistrimin e biznesit, me objekt aktiviteti bimë frutore ulliri.</p>	7.2.2022	<p>Procedura për regjistrimin e biznesit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit është publikuar në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit, në linkun: https://qkb.gov.al/informacion-mbi-proceduren/regjistrimi-i-biznesit/regjistrimi-fillestar/.</p>	Përgjigja është dhënë e plotë	0
6	25.1.2022	<p>Konfirmim nëse organigrama e publikuar në faqen zyrtare të ministrisë është përditësuar, në të kundërt kërkohet versioni i përditësuar i saj.</p>	22.2.2022	<p>Lidhur me sa më sipër, sqarohet në linkun https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/01/OrgS_hqip.pdf është publikuar</p>	Përgjigja është dhënë e plotë	0

				organika e përditësuar e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, miratuar me Urdhrin Nr. 150, datë 9.11.2020 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”, të ndryshuar.		
7	26.1.2022	Informacion se ku duhet të dorëzohen dokumentat për aplikim për mbështetje me grant për investim në agroturizëm.	7.2.2022	Procedura për aplikim është publikuar në linkun http://www.azhbr.gov.al/ipard-ii-thirrja-e-katert/ .	Përgjigja është dhënë e plotë	0
8	26.1.2022	Informacion në lidhje me prodhimin e birrës në Shqipëri për 5 vitet e fundit (2017 – 2021), si dhe listën e prodhuesve të birrës në vend.	7.2.2022	Në bazë të ligjit nr. 17/2018, datë 5.4.2018 “Për statistikat zyrtare”, i ndryshuar, për qëllime kërkimore – studimore apo të tjera, INSTAT është i vetmi autoritet zyrtar përgjegjës për publikimin dhe shpërndarjen e informacioneve statistikore zyrtare në Shqipëri. Personat e interesuar mund t’i drejtohen me kërkesë INSTAT-it duke plotësuar të dhënat në formularin sipas linkut http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/k%26abrko-	Përgjigja është dhënë e plotë	0

				t% c3% ab- dh% c3% abna/k% c3% abrkes% c3% ab-t% c3% ab- dh% c3% abnash-formulari/ .		
9	30.1.2022	<p>1. A ka ministria një ekspozitë të dëmeve të shkaktuara në bujqësi në dy vitet e fundit nga dukuritë natyrore? Nëse po, sa dëme janë identifikuar, sa ka qenë vlera në lekë për secilin dëm?</p> <p>2. Cila ka qenë politika që ka ndjekur ministria sa u takon këtyre rasteve nga dëmet natyrore? A ka pasur dëmshpërblime? Nëse po a mund të na vihen në dispozicion të dhënat për secilin rast?</p> <p>3. Në afatgjatë, si do të ndihmojë ministria në minimizimet e dëmeve në bujqësi? A ka një plan? Një strategji?</p> <p>4. Cilat fenomene natyrore kanë sjellë më shumë dëme në bujqësinë shqiptare?</p>	11.2.2022	Bashkëlidhur informacioni.	Përgjigja është dhënë e plotë	0
10	2.2.2022	Informacion nëse ka një udhëzim për përcaktimin e	11.2.2022	Referuar pikës 3, shkonja “c” të VKM-së Nr. 509, datë	Deleguar	0

		rregullave dhe procedurave në rastet kur lejohet djegia e kullotës apo livadhit.		13.9.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit”, sektori i pyjeve dhe kullotave është në përgjegjësinë shtetërore të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” kërkesa i është dërguar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit në adresën fludian.cuka@turizmi.gov.al .		
11	3.2.2022	1. Sa kanë qenë eksportet e peshkut përgjatë 3 viteve të fundit? 2. Sa është sasia e peshkut të kapur në brigjet tona dhe sa është sasia e përpunuar nga importet? 3. Sa është numri i flotës detare të peshkimit në vend? Prej sa peshkatarësh përbëhet? 4. Në cilat vende eksportojmë ne peshk?	22.2.2022	Bashkëlidhur informacioni.	Përgjigja është dhënë e plotë	0

		5. Cilat lloje të produkteve të detit dhe peshkut eksportojmë?				
12	8.2.2022	<p>1. Sa përqind të tregut zë prodhimi bujqësor vendas në raport me atë të importuar? Si ka ndryshuar trendi në 3 vitet e fundit?</p> <p>2. Cilat produkte eksportojmë në vendet e BE? Sa është sasia e tyre? Sa është sasia e prodhimeve të importit që përpunohen me qëllim eksportin?</p> <p>3. Drejt cilit vend të BE eksportojmë prodhime bujqësore?</p>	22.2.2022	<p>Në bazë të Ligjit Nr. 17/2018, datë 5.4.2018 “Për statistikat zyrtare”, i ndryshuar, INSTAT është i vetmi autoritet zyrtar përgjegjës për publikimin dhe shpërndarjen e informacioneve statistikore zyrtare në Shqipëri. Të dhënat mbi tregtinë e jashtme i gjeni në linkun: http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/?rxid=1fe6ed3f-ee51-4f95-8273-f3cf5416f79f .</p> <p>Të dhënat për sasinë e prodhimeve bujqësore të eksportuara nga Shqipëria i gjeni në linkun: http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START_FT_FTM/NewFTM001/?rxid=1fe6ed3f-ee51-4f95-8273-f3cf5416f79f .</p> <p>Nëse në faqen zyrtare të INSTAT nuk gjeni të dhëna statistikore apo informacionin e dëshiruar, mund t’i drejtoheni me kërkesë INSTAT-it duke plotësuar të dhënat në formularin sipas linkut http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/k%3%abrko-t%3%ab-dh%3%abna/k%3%abrkes%3</p>	Përgjigja është dhënë e plotë	0

				%ab-t%c3%ab-dh%c3%abnash-formulari/		
13	8.2.2022	<p>1. Si paraqitet situata me eksportet së fundmi dhe përse eksportuesit po hasin vështirësi lidhur me analizat e produktit në kufi?</p> <p>2. Cilat produkte zënë peshën më të lartë të eksporteve bujqësore?</p> <p>3. Drejt cilave vende eksportojmë, si dhe sa po ndihmon certifikata fitosanitare?</p>	25.2.2022	Bashkëlidhur informacioni.	Përgjigja është dhënë e plotë	0
14	14.2.2022	<p>1. Vënien në dispozicion të statistikave të peshkimit në të gjithë vendin për 5 vitet e fundit, të ndara sipas viteve.</p> <p>2. Statistikat e Qarkut të Lezhës për 5 vitet e fundit, të ndara sipas viteve.</p> <p>3. A ka ndikuar ndotja e lagunave në Lezhë në rënien e sasisë së peshkut apo gjallesave të tjera nënujore?</p>	22.2.2022	Bashkëlidhur informacioni.	Përgjigja është dhënë e plotë	0
15	17.2.2022	1. Referuar kuadrit ligjor në fuqi, a kërkohet pajisja me kartë fermeri për personat juridik?	8.3.2022	Bashkëlidhur informacioni	Përgjigja është dhënë e plotë	0

		<p>2. Cila është procedura që ndiqet dhe dokumentacioni që duhet të depozitohet për t'u pajisur me kartë fermeri për personat juridik?</p> <p>3. Cila është procedura që ndiqet dhe dokumentacioni që duhet të depozitohet për t'u regjistruar në Regjistrin Rajonal të Fermave për personat juridik?</p>				
16	17.2.2022	<p>1. Sa është sasia e druve të eksportuar përgjatë 3 viteve të fundit?</p> <p>2. Çfarë lloji drusor eksportojmë?</p> <p>3. Si është kategorizuar në eksport?</p> <p>4. Drejt cilave vende eksportojmë?</p> <p>5. Sa është sasia e lëndës drusore të përfituar nga krasitja e ullinjve? Sa është sasia e tyre e eksportuar?</p>	8.3.2022	<p>Në bazë të Ligjit Nr. 17/2018, datë 5.4.2018 “Për statistikën zyrtare”, i ndryshuar, INSTAT është i vetmi autoritet zyrtar përgjegjës për publikimin dhe shpërndarjen e informacioneve statistikore zyrtare në Shqipëri. Të dhënat mbi tregtinë e jashtme i gjeni në linkun: http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/?rxid=1fe6ed3f-ee51-4f95-8273-f3cf5416f79f . Të dhënat për sasinë e mallrave të eksportuara nga Shqipëria i gjeni në linkun: http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START_FT_FTM/NewFTM001/?rxid=1fe6ed3f-ee51-4f95-8273-f3cf5416f79f . Nëse në faqen zyrtare të INSTAT nuk gjeni të dhëna statistikore apo informacionin</p>	Përgjigja është dhënë e plotë	0

				e dëshiruar, mund t'i drejtoheni me kërkesë INSTAT-it duke plotësuar të dhënat në formularin sipas linkut http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/k%3%abrko-t%3%ab-dh%3%abna/k%3%abrkes%3%ab-t%3%ab-dh%3%abnash-formulari/ .		
17	17.2.2022	<p>1. Cila nga skemat do të përdoret dhe nëse përfshihet dhe ajo e lekë për litër, pse nuk është në dokumentin e miratuar nga Këshilli i Ministrave?</p> <p>2. Nëse qëndron e kundërta, pse është përmendur nga vetë ministrja dhe nuk është aplikuar?</p>	8.3.2022	<p>Me VKM-në Nr. 101, datë 9.2.2022, si dhe me Udhëzimin e përbashkët Nr. 1, datë, 11.2.2022, janë përcaktuar masat, kriteret, procedurat dhe mënyra e administrimit tëfondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2022.</p> <p>1. Në masat e parashikuara për blegtorinë është përfshirë mbështetja për krerë, pasi kjo është një masë e thjeshtë dhe e drejtpërdrejtë për t'u zbatuar;</p> <p>2. Pagesa për prodhim qumështi nuk është stimuluese për të imtat. Po ashtu, është masë e komplikuar dhe e vështirë në zbatim, plus që një</p>	Përgjigja është dhënë e plotë	0

				<p>pjesë e madhe e fermerëve në zonat e thella rurale nuk sigurojnë dot fatura dhe nga ana tjetër një pjesë e subjekteve përpunuese të qumështit janë sezonale dhe i pagujnë fermerët pasi kanë shitur djathin apo nënproduktet e përpunimit, pra ndoshta edhe pas 6 muajsh nga momenti i marrjes së qumështit prej tyre.</p> <p>Theksojmë që, të dyja llojet e masave, si për krerë, ashtu edhe për prodhim qumështi synojnë uljen e kostove të prodhimit. Për këto arsye, për këtë vit u gjykua si më e përshtatshme pagesa për krerë.</p>		
18	6.3.2022	Cili institucion shtetëror është përgjegjës për çënimin e pronës nga hapja dhe zgjerimi i lumit Drin në Lezhë?	24.3.2022	<p>Për informacion mbi zgjerimin e lumit Drin, Lezhë, kërkuesi mund t'i drejtohet Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë. Në VKM-në Nr. 437, datë 17.5.2017 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Drejtorive të Ujitjes dhe të</p>	Përgjigja është dhënë e plotë	0


				<p><i>Kullimit Lezhë, Durrës, Fierdhe Korçë”, përcaktohet se: “Drejtoritë e ujitjes dhe të kullimit, përveç sa përcaktohet në nenin 13, të ligjit nr.24/2017, “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”, bashkëpunojnë dhe koordinojnë punën me bashkitë, organet përkatëse të menaxhimit të integruar të burimeve ujore, organet përkatëse të emergjencave civile, mbrojtjes së mjedisit etj., për planifikimin e nevojave për ujë për ujitje, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e sistemeve të ujitjes, të kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytja”.</i></p>		
19	20.4.2022	Çfarë procedure prokurimi është ndjekur për përcaktimin e kompanisë fituese (KASTRATI Group) të furnizimit të fermerëve me naftën falas? Cila kanë qënë kriteret e përzgjedhjes?	4.5.2022	Bashkëlidhur informacioni/Dokumentat standarde të tenderit	Përgjigja është dhënë e plotë	0
20	21.4.2022	<ol style="list-style-type: none"> 1. Sa janë kuotat e lejeve të peshkimit në liqenet e Ohrit dhe Prespes? 2. A janë kuota fikse apo ndryshojnë në varësi të situatave të caktuara? 3. Mbi çfarë kriteresh përcaktohen kuotat për lejet e peshkimit? 4. Cilat janë kriteret që duhet të përmbuhin peshkatarët për të përfituar lejen e peshkimit? 5. Kush i përcakton kuotat e peshkimit dhe cili është roli i OMP-ve në këtë proces? 	2.6.2022	<p>Bashkëlidhur informacioni</p> <p>1.Sa janë kuotat e lejeve të peshkimit në liqenet e Ohrit dhe Prespes?</p> <p>Në zbatim të urdhrit të Ministrit nr. 136, datë 28.3.2022 “Për përcaktimin e numrit të lejuar të lejeve të peshkimit dhe të anëtarësisë të Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (OMP), Pogradec”, numri maksimal i varkave të peshkimit të pajisura me leje do të jetë deri në 220 (dyqind e njëzet) dhe numri maksimal i lejuar i peshkatarëve profesionistë, anëtarë të OMP Pogradec do të jetë</p>	Përgjigja është dhënë e plotë	0

		<p>6. A ka instrumenta apo struktura ministria për të kontrolluar nëse lejet janë shpërndarë konform ligjit apo statutit të OMP-ve?</p> <p>7. A janë të mjaftueshme kuotat që përcakton ministria në raport me kërkesën që vjen nga peshkatarët e Pogradecit, Pustecit dhe Devollit?</p> <p>8. Menaxhimi i liqeneve nga OMP-te e ka reduktuar peshkimin e paligjshëm apo e ka rritur?</p> <p>9. Sa raste të peshkimit të paligjshëm në këto 3 liqene dhe sa masa sekuestro janë vendosur në 2 vitet e fundit?</p> <p>10. Si po zbatohet marrëveshja e vitit 2020 nënshkruar mes Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut për ruajtjen, monitorimin dhe menaxhimin e peshkimit në liqenin e Ohrit dhe liqenin e Prespës?</p>	<p>jo më shumë se 290 (dyqind e nëntëdhjete) peshkatarë.</p> <p>Në zbatim të pikës 1, të nenit 5 të kontratës nr. 783/1, datë 24.1.2018 për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit/akuakulturës në liqenin e Prespës së Madhe dhe të Vogël me OMP Prespë, numri maksimal i subjekteve (varkave) të peshkimit është 60 (gjashtëdhjetë).</p> <p>2. A janë kuota fikse apo ndryshojnë në varësi të situatave të caktuara?</p> <p>Kuotat/numri i lejeve të peshkimit është fiks, i përcaktuar në aktet e cituara më sipër dhe mund të ndryshohet vetëm me një akt që shfuqizon aktin në fuqi.</p> <p>3. Mbi çfarë kriteresh përcaktohen kuotat për lejet e peshkimit?</p> <p>Për liqenin e Ohrit, kuotat për lejet e peshkimit, janë përcaktuar sipas Planit të bashkëmenaxhimit të liqenit të Ohrit, të hartuar nga OMP Pogradec dhe të miratuar nga Ministri me Akt-Miratimi Nr. 3911/1prot., datë 27.5.2016, duke vlerësuar kërkesat e bëra nga OMP-të e Pogradecit dhe Prespës së Madhe dhe të Vogël si dhe historikun e numrit të subjekteve që kanë zhvilluar peshkim ndër vite në këto objekte ujore.</p> <p>4. Cilat janë kriteret që duhet të përmbushin peshkatarët për të përfituar lejen e peshkimit?</p> <p>Në liqenin e Ohrit ushtron aktivitet peshkimi OMP-Pogradec sipas kontratës Nr. 6043 Prot datë 02.08.2016 “Për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit në liqenin e Ohrit e shpallur si zonë bashkëmenaxhuese peshkimi”, lidhur me MBZHR me afat 10 vjeçar dhe në liqenin e Prespës së Madhe dhe Prespës së Vogël ushtron aktivitet peshkimi OMP-Prespë sipas kontratës Nr. 783/1 prot., date 24.1.2018 lidhur me MBZHR me afat 10 vjeçar.</p> <p>OMP-Pogradec dhe OMP-Prespë pajisin anëtarët e tyre me lejen për ushtrimin e së drejtës së</p>		
--	--	--	---	--	--

			<p>veprimtarisë së peshkimit. Në lëshimin e lejes OMP sigurohet që çdo anëtar të jetë i pajisur me dokumentacionin përkatës (Ekstraktin e QKB-së, Certifikatën e mjetit lundrues, Mandat pagesën e taksës vjetore për zhvillimin e aktivitetit).</p> <p>5. Kush i përcakton kuotat e peshkimit dhe cili është roli i OMP-ve në këtë proces? Kuotat e lejeve të peshkimit, përcaktohen në aktet e cituara në përgjigjen e pyetjes 1, OMP-te lëshojnë lejet e peshkimit për peshkatarët që janë anëtarë të tyre.</p> <p>6. A ka instrumente apo struktura ministria për të kontrolluar nëse lejet janë shpërndarë konform ligjit apo statutit të OMP-ve? Kontrolli në terren i ushtrimit të aktivitetit të peshkimit nga ana e OMP-ve, kryhet nga Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës (DSHPA), institucion në varësi të MBZHR i cili ushtron funksionet nëpërmjet Sektorit të Inspektimit dhe Kontrollit të Peshkimit dhe Sektorit të Monitorimit.</p> <p>7. A janë të mjaftueshme kuotat që përcakton ministria në raport me kërkesën që vjen nga peshkatarët e Pogradecit, Pustecit dhe Devollit? Qëllimi i vendosjes së një numri të mbyllur të lejeve të peshkimit është mbrojtja e resurseve. Nuk mund të peshkojnë një numër pa limit peshkatarësh. Numri i lejeve të peshkimit në liqenin e Ohrit, është relativisht i lartë. Përpara viteve 90, në liqenin e Ohrit peshkonte një brigadë peshkatarësh me 28 vetë, ndërsa sot 10 herë më shumë. Në Maqedoninë e Veriut, e cila ka dy të tretat e liqenit, peshkimi është i dhënë me koncesion dhe numri i peshkatarëve është shumë herë më i ulët.</p> <p>8. Menaxhimi i liqeneve nga OMP-te e ka reduktuar peshkimin e paligjshëm apo e ka rritur? Menaxhimi i liqeneve nga OMP-të e ka reduktuar peshkimin e paligjshëm, kjo falë bashkëpunimit të</p>	
--	--	--	---	--

			<p>këtyre OMP-ve dhe me strukturën e Sektorit të Inspektimit dhe Kontrollit të Peshkimit (pjesë strukturore e DSHPA-së).</p> <p>OMP janë struktura të krijuara dhe njohura sipas ligjit. Qëllimi i tyre është përfshirja e grupeve të interesit në menaxhimin e peshkimit. Mbrojtja e resurseve është më efektive kur në këtë proces përfshihen grupet e interesit. Janë këto grupe interesi më të interesuara të mbrojnë peshkimin se sa ministria ose pushteti vendor. Ata kanë të lidhur jetesën e tyre me resurset. Për këtë qëllim OMP japin ndihmesën e tyre për mbrojtjen e resurseve duke ndihmuar në luftën ndaj peshkimit të paligjshëm.</p> <p>9. Sa raste të peshkimit të paligjshëm në këto 3 liqene dhe sa masa sekuestro janë vendosur në 2 vitet e fundit?</p> <p>Spektori i Inspektimit dhe Kontrollit të Peshkimit në bashkëpunim me Organizatat e Menaxhimit të Peshkimit Pogradec dhe Prespë si dhe Policinë e Kufirit dhe Migracionit gjatë dy viteve të fundit në zbatim edhe të urdhrave të ministrit “Për ndalimin e peshkimit në Liqenet e Ohrit dhe Prespës”, ka marrë 7 masa administrative vendim me gjobë, në zbatim të Ligjit nr. 64/2012 “Për Peshkimin” , i ndryshuar.</p> <p>10. Si po zbatohet marrëveshja e vitit 2020 nënshkruar mes Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut për ruajtjen, monitorimin dhe menaxhimin e peshkimit në liqenin e Ohrit dhe liqenin e Prespës?</p> <p>Me nënshkrimin e marrëveshjes midis dy vendeve “Mbi Menaxhimin e qëndrueshëm të përbashkët të liqenit të Ohrit dhe Prespës së Madhe” dhe në zbatim të parashikimeve të saj është krijuar Komiteti i Përbashkët i Peshkimit. Në shtator të vitit 2021, me ftesë të palës shqiptare është mbajtur takimi i parë i këtij Komiteti. Gjatë këtij takimi palët shkëmbyen informacion në lidhje me çështjet</p>
--	--	--	---

				<p>e menaxhimit të peshkimit si dimensionet minimale për specie specifike, periudhat e ndalimit, veglat e lejuara të peshkimit (lloji, karakteristikat teknike, numri etj.), periudhat e ripopullimit etj.</p> <p>Palët kanë shkëmbyer aktet ligjore kombëtare të peshkimit (ligjet dhe rregulloret e brendshme) në mënyrë që të njihen më mirë me dispozitat ligjore në vendet përkatëse dhe të angazhohen për harmonizimin e dispozitave dhe politikave të tyre të brendshme. Të dyja palët ranë dakord që në takimin e radhës, i cili bazuar marrëveshjes zhvillohet me ftesë të palës së Maqedonisë së Veriut, të marrin pjesë ekspertë shkencorë apo grupe interesi për të marrë masa konkrete teknike si dhe për të dhënë rekomandime.</p>		
21.	20.5.2022	<p>Bazuar ne mbikeqyrjen e sigurise ushqimore ne Shqiperi per vitin 2021, cilat rezultojne produktet qe perbejne rrezik ose nuk kane permbushur standartet e duhura ne treg?</p> <p>Nga analizimi, kontrollimi dhe monitorimi i produkteve shtazore (ne vend dhe te importuara) cilat jane rezultatet per perdorimin e sasise se hormoneve dhe sigurise se tyre ndaj konsumatorit?</p>	23.5.2022	<p>Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” kërkesa i është dërguar AKU-së në adresën eda.gazheli@aku.gov.al</p>	Deleguar	0
22.	31.5.2022	<p>Në bazë të ligjit nr119/2014 për të drejtën e informimit, më poshtë jam duke u dërguar kërkesën për informacion lidhur me si më poshtë ;</p> <p>1- Fshatrat Boboshticë, Zvirinë dhe Zaroshkë në qarkun e Korçës janë të përhira në projektin e 100 fshatrave. Cilat kanë qenë punët, ndërhyrjet apo përfitimi i këtyre fshatrave nga projekti "100 fshatra"? Cila është gjendja që momentalisht ndodhemi?</p> <p>2 - A ka pasur alokim fondesh për projekte specifike, sa dhe cilat?</p>	24.6.2022	<p>1. Në kuadër të programit “100 fshatrat”, pjesë e të cilit është dhe MBZHR, janë dhënë fonde nga buxheti i shtetit, përmes masave kombëtare. Po kështu, për këtë program është dhënë mbështetje nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, që kanë të bëjnë me sistem asfaltim rruge, programe për turizmin, program per zhvillimin rajonal (rehabilitim i bregut, infrastrukturë publike, etj). Përfitimi është gjallërimi dhe përmirësimi i jetës së fshatit, përmes vizitorëve të agroturizmit, shtimi i punësimit, dhe promovimi i produkteve dhe gatimeve të zonës. Agroturizimi i ngritur me fonde të buxhetit, aktualisht funksionon.</p>	Përgjigja i është kufizuar sepse i deleguar edhe Fondit Shqiptar i Zhvillimit	0


		<p>3 - A ka projekte që pritet të implementohen në këto fshatra, cilat janë nënq po, dhe çfarë ka qenë pengesë për moszhvillimin e tyre deri më sot?</p>		<p>2. Me fonde të buxhetit është financuar Agroturizimi në fshatin Boboshticë, me përfitues Z. Vasillaq Xhufka, në vlerë 7 548 801 lekë. Nga FSHZH: Nga të dhënat e marra rezultojnë se:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Fshati Boboshticë: Programi për turizimin, financuar nga BERZH dhe EU me vlerë 246 874 668 lekë, është në fazën e projektimit; -Fshati Zvirinë: Sistemim asfaltim rruga hyrëse në fshatin Zvirinë, faza e parë, financuar nga buxheti me vlerë 128 450 579 lekë, është në proces prokurimi; -Fshati Zaroshkë: Rehabilitim i bregut, infrastrukturë publike, financuar nga KFW me vlerë 861 000 000 lekë, është përgatitur koncepti i zhvillimit dhe kanë nisur procedurat për hartimin e Marrëveshjeve të Financimit. <p>3. Projektet nga FSHZH pritet të implementohen. Bëjmë me dije se të dhënat nga FSHZH janë marrë përmes shkresës zyrtare nr. 683/1 datë 16.3.2022 (bashkëlidhur).</p> <div style="text-align: center;">  OBJKTET-FINANCUARA-PROGRAMI-100-FSHATRAVE.pdf </div> <p>Gjithashtu, ju bëjmë me dije se MBZHR po përcjell këtë informacion për atë që disponon si institucion sepse me miratimin e Ligjit Nr. 115/2021 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022”, zbatimi i investimeve të programit 100 fshatrat (Programi të Integruar të Zhvillimit Rural) i ka kaluar Fondit Shqiptar të Zhvillimit.</p> <p>Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, kjo kërkesë i është deleguar FSHZH në adresën e mëposhtme: aidrizi@albaniandf.org</p>		
23.	31.5.2022	<p>Në bazë të ligjit nr.119/2014, për të drejtën e informimit. Kërkoj informacion për tokat shtetërore me qera, dhe si mund ta gjeje zonën kadastrale.</p>	7.6.2022	<p>Në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në lidhje me kërkesën tuaj ju bëjmë me dije se: “Lista e tokave objekt qiradhënie është tek website-i zyrtar i MBZHR, ku ngastrat tokë</p>	Përgjigja është dhënë e plotë	0

				<p>bujqësore, objekt qiradhënie janë të identifikuara me numër pasurie si dhe Zona Kadastrale ku ato ndodhen.</p> <p>Për lehtësinë tuaj këtë informacion mund ta aksesoni edhe në linkun https://bujqesia.gov.al/lista-e-tokave-me-qira/”</p>		
24.	8.6.2022	<p>Kërkoj prej institucionit të MBZHR informacion lidhur me:</p> <ul style="list-style-type: none"> •Çfarë procedure prokurimi është ndjekur për përcaktimin e kompanisë fituese (KASTRATI Group) të furnizimit të fermerëve me naftën falas? •Sa kompani kanë qënë pjesmarrëse, cilat kanë qënë? •Çfarë procedure u ndoq për përzgjedhjen e kompanisë fituese? •A ka patur ankimim në procedurën e ndjekur nga kompanitë e tjera? 	17.6.2022	<p>Sipas legjislacionit të prokurimit publik në fuqi, procedura e prokurimit është procedura e hapurë mbi kufirin e lartë monetar.</p> <p>Në procedurën e prokurimit me nr. REF-18820-02-07-2022, bashkimi i operatorëve ekonomik “Kastrati shpk & Kastrati Group sha” kanë qënë ofertues të vetëm.</p> <p>Përzgjedhja e kompanisë fituese në këtë procedure ka qënë në bazë të kriterëve ligjore, ekonomike dhe teknike të Dokumentave Standarteve të Tenderit të cilat kanë qënë publike të shpalluara në Sistemin e Prokurimit Publik(SPE) e cila është publike dhe mund të marri pjesë çdo operator ekonomik i cili plotëson kushtet dhe kriteret.</p> <p>Në procedurën e prokurimit publik me nr. REF-18820-02-07-2022 nuk ka patur asnjë ankesë nga operatorë të tjerë ekonomik as ne fazën e publikimit të Dokumentave Standarte të Tenderit as në fazën e vlerësimit të ofertave.</p>	Përgjigja është dhënë e plotë	0
25.	16.6.2022	<p>Kerkese per informacion rreth aplikimit per miratim te projektit per frigorifer, kompleks blegtoral, stalle dhensh ne fshatin Qyrkan, Cerrik. Numri i protokollit eshte 329, date 15 janar 2020.</p> <p>Mund te na vendosni ne dispozicion aplikimin dhe projektin qe eshte kerkuar per miratim?</p>	22.6.2022	<p>Duke qënë se institucioni përgjegjës që ofron shërbime të drejtpërdrejta për fermerët vendas, që zbaton politikat shtetërore për zhvillimin bujqësor dhe rural dhe që ndjek procedurën e këtyre aplikimeve është AZHBR, bazuar në nenin 12, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, kjo kërkesë i është deleguar AZHBR-së.</p>	Deleguar	0
26.	22.6.2022	<p>Përshëndetje, në bazë të ligjit për të drejtën e informimit, do të donim të dinim a është bërë dezinfektimi për mushkonjat këtë vit në zonat turistike, nëse po, ku, dhe nëse jo, pse?”</p>	24.6.2022	<p>Bazuar në nenin 33, të Ligjit nr. 10 138, datë 11.5.2009 “Për shëndetin publik”, të ndryshuar, lista e lëndëve që përdoren për dezinfektim miratohet çdo vit nga Ministri i Shëndetësisë. Gjithashtu, përdorimi i lëndëve që përdoren për dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim</p>	Deleguar	0






				rregullohet me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë. Sa më sipër, bazuar në nenin 12, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, kërkesa i është deleguar MSHMS ne adresen nertila.kodra@shendetesia.gov.al		
27.	22.6.2022	<p>1- Sa është numri i Pikave të Grumbullimit të Prodhimeve bujqësore ne Lushnje dhe Divjakë.</p> <p>2- Sa prej këtyre pikave të grumbullimit kanë përfituar nga fondet e AZHBR për investime në sektorin e bujqësisë?</p> <p>3- Sa është totali i subvencioneve, që Pikat e Grumbullimit në Lushnje dhe Divjakë, kanë përfituar gjatë pesë viteve të fundit!</p> <p>4- Ju lutem, na vini në dispozicion emrat e pikave të grumbullimit në Lushnje dhe Divjakë.</p> <p>5- Sa është kapaciteti grumbullues në TON i këtyre pikave të grumbullimit?</p> <p>6- Si i përcaktojnë çmimet e grumbullimit të prodhimeve bujqësore këto pika?</p> <p>7- A referohen çdo ditë në Ministrinë e Bujqësisë çmimet e grumbullimit të prodhimeve bujqësore nga pikat e grumbullimit?</p> <p>8- Ju lutem, na vini në dispozicion çmimet e grumbullimit të: Shalqinit, Pjeprit, Domates, Specit, Kastravecit, Patëllxhanit, Lakrës, Lulelakrës, Karrotës etj, gjatë muajit Mars-Qershor 2022!</p>	4.7.2022	<p>Numri total i Pikave të Grumbullimit të Prodhimeve Bujqësore ne Lushnje dhe Divjakë është 37.</p> <p>Lidhur me përcaktimet e çmimeve të grumbullimit, lista e çmimeve që monitoron Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është e reduktuar për disa artikuj që përdoren vetëm për qëllime statistikore dhe nuk mund të përdoren për çmime reference. Sugjerojmë INSTAT, si i vetmi institucion për publikim të të dhënave statistikore , përfshirë këtu dhe informacione të kërkuar nga ju.</p> <p>Ndërsa kërkesa për fondin total të subvencioneve i është deleguar AZHBR si institucion përgjegjës.</p>	Përgjigja i është dhënë e kufizuar sepse i është deleguar edhe AZHBR-ës.	0
28.	30.6.2022	Kërkesë për informacion duke kërkuar vënien në dispozicion të vendimmarrjes lidhur me revokimin e licencave të 4 (katër) subjekteve të prodhimit dhe përpunimit të produkteve të duhanit, të cilat ndodhen në një proces gjyqësor me	8.7.2022	Me miratimin e vendimit nr. 437, datë 26.6.2019 “Për kriteret e licencimit të Veprimtarive të përpunimit industrial të duhanit dhe/ose prodhimit të produkteve të duhanit”, u shtuan kriteret e reja për licencim, të gjithë operatorëve të licencuar ju la një afat 3-mujor për marrjen e masave për plotësimin e këtyre kriterëve. Në zbatim të pikës 8,	Deleguar	0




		MBZHR.		të vendimit nr. 437/2019, me mbarimin e këtij afati, AKDC-ja ka revokuar licencat e këtyre subjekteve. Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, duke qenë se AKDC është organi përgjegjës për revokimin e licencave dhe që disponon kopje të këtyre akteve, kërkesa i është deleguar AKDC.		
29.	5.7.2022	<p>Aktualisht po shkruajmë një artikull mbi deklaratat e kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, se objektivat e vendit janë që eksportet bujqësore të arrijnë shifrat e 1 miliard dollarëve. Do të doja të kisha disa përgjigje nga ministria.</p> <p>1- Fillimisht me cilat produkte pritet që vendi jonë ta arrijë këtë shifër?</p> <p>2- Cilat janë politikat mbështetëse të qeverisë për fermerët?</p> <p>A ka Shqipëria ndonjë produkt bujqësor me të cilin mund të konkurrojë në tregun evropian?</p>	29.7.2022	<p>Referuar kërkeses lidhur me eksportet sqarojmë se: Vendi ynë aktualisht ka një numër produktesh që po eksportohen në mënyrë të qëndrueshme në treg. Mbi këtë bazë është përcaktuar edhe objektivi për të arritur shifrën 1 miliard dollarë eksporte në vitin 2030.</p> <p>Grupet e produkteve me potencial më të lartë eksporti janë perimet dhe frutat, bimët mjekësore dhe aromatike dhe produktet e peshkut dhe akuakulturës.</p> <p>Eksporti i fruta-perimeve në total për vitin 2021 arriti në vlerën 12.3 mld lekë dhe përbën 26.5% të totalit të vlerës së eksporteve të produkteve bujqësore dhe blegtorale (nga të cilat 72% e përbëjnë Perimet dhe 28% Frutat). Specifikisht ndaj totalit të vlerës së eksporteve bujqësore dhe blegtorale, eksporti i perimeve përbën 19% të vlerës totale dhe eksporti i frutave 8%. Top shtetet e destinacionit të eksporteve të perimeve për vitin 2021 janë Italia, Bosnia & Herzegovina, Serbia, Maqedonia, Kosova, etj dhe të frutave Italia, Çekia, Bosnia & Herzegovina, Serbia, Kosova etj.</p> <p>Eksporti i BAM për vitin 2021 arriti në vlerën 5.4 mld lekë dhe përbën 11.6% të totalit të vlerës së eksporteve të produkteve bujqësore dhe blegtorale. Top shtetet e destinacionit të BAM për vitin 2021</p>	Përgjigja i është dhënë e plotë	0


				<p>janë Shtetet e Bashkuara, Gjermania, Turqia, Italia, Franca etj.</p> <p>Eksporti i Peshkut të freskët dhe të Konservuar për vitin 2021 arriti në vlerën 15.8 mld lekë dhe përbën 34% të totalit të vlerës së eksporteve të produkteve bujqësore dhe blegtorale (nga të cilat 48% e përbën Peshku i freskët dhe 52% Peshku i Konservuar). Specifikisht ndaj totalit të vlerës së eksporteve bujqësore dhe blegtorale, eksporti i peshkut të freskët përbën 16% të vlerës totale dhe eksporti i peshkut të konservuar 18%. Top shtetet e destinacionit të eksporteve të peshkut të freskët për vitin 2021 janë Italia, Spanja, Kroacia, Japonia, Kosova etj dhe të peshkut të konservuar Italia, Suedia, Estonia, Kroacia, Spanja etj.</p> <p>Politikat mbështetëse që do të vijojnë të zbatohen për fermerët janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Orientimi i fermerëve për të prodhuar kulturat që kërkon tregu, • Pagesat direkte që synojnë uljen e kostove të prodhimit, • Mbështetje për investime që synojnë rritjen e sipërfaqeve dhe sidomos investime në ambiente të mbrojtura (serra dhe tunele plastike), teknologji të reja, inovacione dhe mekanizim; • Shërbime këshillimore dhe marketing. <p>Po kështu, do të vazhdojë të mbështetet rrjeti i pikave të grumbullimit dhe përpunimit të produkteve.”</p>		
30.	26.7.2022	Kërkesa për informacion lidhur me listën e plotë të përfituesve të IPARD II për vitet 2014-2020 dhe listën e aplikuesve dhe	16.8.2022	Duke qenë se institucioni përgjegjës që ofron shërbime të drejtpërdrejta për fermerët vendas, që zbaton politikat shtetërore për zhvillimin bujqësor dhe rural dhe që ndjek procedurën e këtyre	Deleguar	0

		përfituesve të IPARD III për vitet 2021-2027.		aplikimeve është AZHBR, bazuar në nenin 12, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i është deleguar AZHBR-së.		
31.	10.8.2022	1-Sa është numri total i personave që kanë përfituar mbështetje financiare nga Skema Kombëtare Mbështetëse gjatë periudhës janar- dhjetor 2021? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj? 2. Sa është numri total i te rinjve (15-29 vjeç) që kanë përfituar mbështetje financiare nga Skema Kombëtare Mbështetëse gjatë periudhës janar- dhjetor 2021? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj?	8.9.2022	<i>Përgjigja është koordiuar me AZHBR.</i> Numri total i personave që kanë përfituar mbështetje financiare nga Skema Kombëtare Mbështetëse gjatë periudhës janar-dhjetor 2021 është 25,983 përfitues, prej të cilëve 19,225 fermerë kanë përfituar vetëm nga masa e mbështetjes me naftë për bujqësinë. Ndërkohë për masat e tjera mbështetëse kanë përfituar 6,758 aplikues, ku 1,164 prej tyre janë përfitues femra dhe 5,594 përfitues meshkuj. Numri total i të rinjve (15-29 vjeç) që kanë përfituar mbështetje financiare nga Skema Kombëtare Mbështetëse (me përjashtim të masës mbështetëse të naftës) gjatë periudhës janar-dhjetor 2021 është 176, prej tyre 29 përfitues janë femra dhe 147 përfitues meshkuj.	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0
32.	30.8.2022	1. Sa është sipërfaqja e tokës së vaditur në hektarë për vitin 2022? 2. Sa ka qenë sipërfaqja e tokës së vaditur në hektarë për vitin 2021, 2020, 2019, 2018 dhe 2017? 3. Sa kanë qenë dëmet në sektorin e bujqësisë nga fatkeqësitë natyrore në 5 vitet e fundit në lekë dhe të ndara sipas ngjarjeve? 4. Sa kilometër kanale ujitëse është në përdorim nga fermerët për vitin 2022? 5. Sa kilometër kanal ujites është përdorur në vitin 2021, 2020, 2019, 2018 dhe 2017?	28.9.2022	 Përshkrim i detajuar i informacionit të kë	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0






		<p>6. Na rendisni sipas kulturave bujqësore rendimentin për hektarë për vitin 2022 dhe për 5 vitet para ardhëse</p> <p>7. Cfarë ka bërë Ministria për të minimizuar efektet e ndryshimeve klimaterike në Shqipëri dhe konkretisht në sektorin e bujqësisë? A ka ministria plane të qarta veprimi në këtë drejtim?</p> <p>8. A ka trajnuar Ministria e Bujqësisë fermerët dhe blektorët për t'i njohur ata me rreziqet e ndryshime klimatike?</p> <p>9. A kanë ndryshuar në Shqipëri kulturat bujqësore për shkak të ndryshimeve klimatike?</p>				
33.	15.9.2022	<p>Ne lidhje me Vkm ne 434, te dates 11.07.2018, te ndryshuar ne vitin 2020 per 'Etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit' kerkojme te dime:</p> <p>Kush eshte laborator i akredituar per berjen e analizes per etiketen e re?</p> <p>Pse keto analiza nuk behen me prane Isuv?</p>	30.9.2022	<p>Lista e laboratorëve të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), duke përfshirë testet laboratorike për të cilat janë akredituar, gjenden të publikuara në faqen zyrtare të DPA (më poshtë gjeni edhe linkun). Linku : http://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/</p> <p>Së dyti, ju bëjmë me dije se bazuar në nenin 46 të Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 "Për Ushqimin", i ndryshuar, laboratorët e ISUV janë laboratorë reference, për çdo analizë të kryer, për kontrollin zyrtar të sigurisë së ushqimeve. Analizat që kryhen për etiketimin janë analiza të kryera nga OBU në kuadër të autokontrollit në përmbushje të dispozitave ligjore të parashikuara nga VKM Nr. 434 datë 11.7.2018 "Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit".</p> <p>Së treti, ju informojmë se Laboratorët e Autoritetit Kombëtar janë laboratorë të kontrollit zyrtar dhe si të tillë në zbatim të kërkesave ligjore të Ligjit Nr. 9863 datë 28.01.2008 "Për ushqimin" i ndryshuar, kryejnë analiza në kuadër kontrolli zyrtar për mostra të planifikuara në planin kombëtar të</p>	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0

				kontrolleve zyrtare me bazë risku dhe marrjes së mostrave për ushqimin, ushqimin për kafshë, mbrojtjes së bimëve dhe inputeve bujqësore, si dhe plani i marrjes së mostrave në PIK, për Operatorë të Biznesit Ushqimor, të cilët prodhojnë/përpunojnë/ambalazhojnë produkte të cilat janë të destinuara për t'u nxjerrë në treg.		
34.	16.9.2022	1. A ka përfunduar rehabilitimi i argjinaturës së lumit Shkumbin përgjatë segmentit Gosë-Ballaj? 2. A keni marrë një plan masash për sezonin e vjeshtës në rast përmbytjesh?	30.9.2022	 Pergjigje kerkeses per informacion.doc	Përgjigja është dhënë e plotë.	0
35.	20.9.2022	1. A ka leje shfrytëzimi dhe mbarështimi të faunës ujore, peshkimi dhe forma të tjera të shfrytëzimit të faunës së egër ujore, firma "Dajlani i Nartë" në Lagunën e Nartës në Vlorë? Nëse po, cfarë leje ka kjo firmë? 2. cfarë dokumente pronësie ka paraqitur kjo firmë në Ministrinë e Bujqësisë? Në cfarë kufijsh shtrihet dhe sa hektarë është e gjitha "prona" e kësaj firme? 3. A ka leje të tjera shfrytëzimi që ka dhënë Ministria e Bujqësisë në Lagunën e Nartës në Vlorë? Janë prona private apo prona shtetërore? Ps. A mund të na vini në dispozicion lejen e Ministrisë së Bujqësisë për këtë firmë. Gjithashtu, edhe hartën ku shtrihet "prona" e firmës "Dajlani i Nartë", me NIUS L66613203K.	27.10.2022	 pergjigje.docx  plani i menaxhimit.pdf  lista e peshkatoreve.pdf  kontrate.pdf	Përgjigja është dhënë e plotë.	0
36.	20.9.2022	Sa është fondi i investimeve në kuadër të "Programit të 100 fshatrave turistik" të qeverisë shqiptare që Ministria juaj, sa	3.10.2022	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në kuadër të Programit të 100-fshatrave ka mbështetur 17 subjekte aplikantë nga këto fshatra, në	Përgjigja është dhënë e	0










		kanë përfunduar dhe sa janë në zbatim ende nëse janë?		"Agroturizëm" dhe "Turizëm rural", përmes masave kombëtare. Kjo mbështetje është kryer gjatë periudhës 2018-2021. Fondi i paguar i grantit është rreth 84 milion lekë.	plotë.	
37.	27.9.2022	1. Sa tokë bujqësore ka në Shqipëri? 2. Sa hektarë janë përmbytur në 2021 nga shirat e shumtë dhe sa prej tyre kanë qenë tokë bujqësore? 3. Cilat zona janë përmbytur më shumë në 2021? 4. Sa është rreziku që këto toka të përmbyten sërish? 5. Cila është mbështetja që u jepet fermerëve në këto raste? 6. Nëse keni të dhëna sa % e tokave bujqësore kanë qenë dhe janë të siguruara? 7. Cili është plani dhe mbështetja që Ministria Bujqësisë ka përgatitur për këtë vit?	Kthyer pgj 19.10.2022	 Info i kerkuar.docx	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0
38.	3.10.2022	A mund të më dërgoni në mënyrë më të detajuar se ku janë këto 17 ferma ju lutem?	19.10.2022	 Mbeshtetja Agroturizem, 100 fsh	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0
39.	4.10.2022	1. A mund të më jepni disa të dhëna statistikore për numrin e bletarëve dhe numrin e koshereve të regjistruar në Republikën e Shqipërisë në 10 vitet e fundit? 2. Sa ton mjaltë janë prodhuar në Republikën e Shqipërisë në vit në 10 vitet e fundit? 3. A ka ndonjë lloj mbështetjeje institucionale për bletarët në Republikën e Shqipërisë? A ka subvencione për bletarët	27.10.2022	1. Të dhëna për numrin e koshereve 2012-2021  Te dhena mbi numrin e koshereve, 2. Ky informacion mund të gjenerohet nga INSTAT (Instituti i Statistikave). 3. Sektori i bletarisë është mbështetur dhe vazhdon të mbështetet përmes skemave kombëtare nga buxheti i shtetit. Masa konsiston në mbështetjen e "Bletarisë me	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0

		<p>(çfarë lloji dhe çfarë shume), apo ndonjë lloj mbështetjeje tjetër teknike/edukative për ta?</p> <p>4. Cili është vizioni afatgjatë i bletarisë në Parkun Kombëtar Korab-Koritnik?</p> <p>5. A ka Ministria e Bujqësisë së Shqipërisë apo qeveria shqiptare ndonjë studim (ose analizë) për ndikimin e ndryshimeve klimatike tek bletët në vend? Nëse ekziston një dokument i tillë, cilat janë sfidat kryesore që keni identifikuar?</p> <p>6. Këtu në Maqedoni ka një rritje të mprehtë të çmimit të mjaltit dhe bletarët për këtë fajësojnë rritjen e pajisjeve të nevojshme, krizën ekonomike dhe inflacionin. Si është situata në Shqipëri? A po merr Ministria e Bujqësisë apo Qeveria Shqiptare disa masa për të ndihmuar bletarët në vend?</p>		<p>1000 (një mijë) lekë për koshere, për fermat me jo më pak se 50 (pesëdhjetë) koshere, por jo më shumë se 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë për subjekt.</p> <p>4. Gjatë viteve të fundit, bletaria është katërfishuar numerikisht. Sektori po ecën me hapa të sigurt drejt prodhimit cilësor. Së shpejti do të përfundojë studimi i kapacitetit kullësor, i cili do të shkojë paralelisht me rritjen e numrit në këto zona. Vizioni afatgjatë është kalimi drejt produkteve organike, i cili rrit vlerën e shtuar të sektorit dhe të ardhurat e vetë bletarëve.</p> <p>5. Nuk ka asnjë studim për ndikimin e ndryshimeve klimatike.</p> <p>6. Bletaria është pjesë e skemës kombëtare të mbështetjes. Gjithashtu me ligjin e ri do të forcohet bashkëpunimi me shoqatën dhe federatën e bletarëve, të gjithë bletarët do të regjistrohen në regjistrin e fermave, në regjistrin e kafshëve dhe në shoqatat lokale të bletarëve. Do të hartohen programe për kapacitetin kullësor, monitorimin, lëvizjen e bletëve etj. Do të forcohet bashkëpunimi me pushtetin vendor.</p>		
40.	4.10.2022	<p>1- Sa është vlera e skemës së subvencionimit në Bujqësi gjatë katër viteve të fundit (2019, 2020, 2021 dhe 2022)</p> <p>2- Sa është fondi total i subvencionimit të fermerëve në Lushnje dhe Divjakë (vetëm ata që kanë përfituar në sektorin e bujqësisë për plastmase për sera, tuba uji, karburant etj)</p>	26.10.2022	 <p>syri pergjigje.pdf</p>	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0

	<p>3- Si shpërndahen këto fonde sipas zërave gjatë vitit 2022? Ju lute mi specifikoni psh: X fonde për sera, Y për pika grumbullimi, B për naftë etj.</p> <p>4- Këtë vit, Ministria e Bujqësisë, ka shpallur fituese të fondeve 5 bashki në vend, të cilat kanë përfituar fonde për ndërtimin e pikave të grumbullimit. A është hera e parë që jepen fonde për projekte që dorëzohen nga bashkitë?</p> <p>5- Nëse po, sa është shuma totale e fondeve që kanë fituar bashkitë: Tiranë, Vau Dejës, Bulqizë, Korçë dhe Belsh për pika grumbullimi apo tregje?</p> <p>6- A ka pasur aplikues të tjerë (veç 5 bashkive fituese) për kategorinë e fondeve që lidhen me ndërtimin e pikave të grumbullimit për vitin 2020?</p> <p>7- Projektet fituese të këtyre bashkive, do të subvencionohen vetëm me para nga buxheti i shtetit apo dhe nga IPARD?</p> <p>1- Si funksionojnë pikat e grumbullimit në Shqipëri?</p> <p>2- Si i mbledhin prodhimet bujqësore dhe si funksionon skema e vendosjes së çmimit që pikat e grumbullimit u blejnë prodhimet bujqësore fermerëve?</p> <p>3- A ka një udhëzim nga ministria që pikat e grumbullimit të mbledhin prodhimet e fermerëve pa I dëmtuar këta të fundit?</p> <p>4- A disponon Ministria e Bujqësisë kontrata të pikave të grumbullimit me fermerët lidhur me skemën e grumbullimit me prodhimet bujqësore.</p>			
--	--	--	--	--

		<p>5- Sa e dëmton mungesa e bursave të çmimeve të prodhimeve bujqësore fermerin shqiptarë?</p> <p>6- A ka një referencë çmimesh për grumbullimin e prodhimeve bujqësore?</p> <p>7- Deputeti Erion Braçe ka ngritur shpesh akuza se pikat e grumbullimit abuzojnë me çmimet që vendosin për grumbullimin e prodhimeve bujqësore. A keni koment për këto deklarata?</p>				
41.	5.10.2022	<p>Kërkoj të më vihen në dispozicion relacionet përfundimtare të VKM-ve të miratuara gjatë katër-mujorit të parë të vitit 2022, me propozim të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si në vijim:</p> <p>VKM TË MIRATUARA ME PROPOZIM TË MINISTRIT TË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL</p> <p>Nr. Datë Emërtim akti</p> <p>41 19.1.22 “Për miratimin e marrëveshjes për bashkëpunimin në fushën e veterinarisë, sigurisë ushqimore dhe ushqimit për kafshë dhe fitosanitare në Ballkanin Perëndimor”</p> <p>101 9.2.22 “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondii programit për bujqësinë e zhvillimit rural, për vitin 2022”</p> <p>226 13.4.11 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 317, datë 15.5.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për</p>	<p>27.12.2022 (Bazuar në vendimin nr. 61, dt. 19.12.2022 të Komisioneri</p>	    	Përgjigja është dhënë plotë.	0

		<p>miratimin e rregullave, për përdorimin e qëndrueshëm të produkteve, për mbrojtjen e bimëve dhe kriteret e kualifikimit për përdoruesit””</p> <p>245 20.4.22 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 101, datë 9.2.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2022””</p> <p>283 29.4.22 “Për masat menaxhuese të ruajtjes së burimeve peshkore dhe përfshirjen e institucioneve në marrjen dhe zbatimin e tyre”</p>				
42.	7.10.2022	<p>Po ju kontaktojmë sepse kemi pyetje në lidhje me rregullimin e çajrave dhe çajrave bimor në Shqipëri.</p> <p>A konsiderohen çajrat dhe infuzionet si ushqime konvencionale?</p> <p>A keni ndonjë listë të bimëve që mund të përdoren në çaj dhe infuzione?</p> <p>Rregullat e etiketimit janë ato në Ligjin e Ushqimit: Nr.9863, datë 28.1.2008 PËR USHQIMIN apo ka rregulla specifike për çajrat dhe infuzionet në Shqipëri?</p> <p>A është e mundur të bëhen pretendime shëndetësore për infuzionet dhe çajrat?</p> <p>Nëse nuk ka rregulla specifike në Shqipëri për infuzionet dhe çajrat ose pretendimet</p>	27.10.2022	<p>1.Referuar pikës 1 në nenin 3, të Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për Ushqimin”, ndryshuar, “Ushqim” ose “produkt ushqimor” është çdo substancë ose produkt i përpunuar, pjesërisht i përpunuar ose i papërpunuar, i përcaktuar të jetë ose, për ndonjë arsye, është i konsumueshëm për njerëz. Çajrat dhe infuzionet konsiderohen ushqime.</p> <p>3. Rregullat e etiketimit mbështeten në Ligji nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për Ushqimin”, i ndryshuar dhe VKM Nr. 434, datë 11.7.2018 "Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit", ku përcaktohen të gjitha rregullat e etiketimit të ushqimeve. (bashkelidhur gjeni një shembull etikete për notifikim).</p> <p>4. Në etiketën e produktit nuk është e lejuar të shënohen rekomandime apo përfitime</p>	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0

		për shëndetin, a ndiqni kodeksin dhe/ose rregulloret evropiane? A është e nevojshme të merren hapa specifikë për të tregtuar çajra apo infuzione?		shëndetësore. 5. Legjislacioni që përdoret është i përafëruar me legjislacionin e Bashkimit Evropian. 6. Duke qenë se këto produkte trajtohen si produkte ushqimore, të gjitha hapat specifikë janë si të gjitha produktet ushqimore.   Bimet mjekesore dhe aromatike.jpeg Model etikete për notifikim.jpeg		
43.	11.10.2022	Sa është numri total i personave që kanë aplikuar në skemat e mbështetjes financiare nga ministria juaj për ngritjen e biznesit të tyre gjatë periudhës janar-dhjetor 2021 ? Sa prej tyre janë femra dhe sa janë meshkuj ? Sa është numri i të rinjve (15-29) që kanë aplikuar në skemat e mbështetjes financiare nga ministria juaj për ngritjen e biznesit të tyre gjatë periudhës janar-dhjetor 2021 ? Sa prej tyre janë femra dhe sa janë meshkuj ?	19.10.2022	Numri total i aplikuesve në skemat e mbështetjes financiare për vitin 2021 është 31 319 nga të cilët 19 350 janë aplikantë të skemës së naftës. Ngjashmërisht, aplikantët për skemat e tjera përveç asaj të naftës janë në total 11 969, nga të cilët 1914 janë të gjinisë femërore dhe 10,055 të gjinisë mashkullore. Numri total i aplikuesve deri në moshën 29 vjeç në skemat e mbështetjes financiare për vitin 2021 (përveç skemës së naftës) është 607, nga të cilët 94 aplikant të gjinisë femërore dhe 513 të gjinisë mashkullore.	Përgjigja është dhënë plotë.	0
44.	10.10.2022	Kërkoj të më vihen në dispozicion relacionet përfundimtare të VKM-ve të miratuara gjatë periudhës Maj-Shtator 2022, me propozim të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si në vijim: 307 11.5.22 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 613, datë 27.10.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për	27.12.2022 (Bazuar në vendimin nr. 61, dt. 19.12.2022 të Komisioneri	   relacioni final korrik 10-Jan-2023 1 Relacion 613.pdf relacion zpa.pdf  3.Relacion Strategjia Bujqesise.  5.Relacioni përmirimi AKU.pdf  4.Relacioni KM 2022.pdf  6.Relacioni përmirimi m.pdf	Përgjigja është dhënë plotë.	0

	<p>Drejtorinë e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës”, të ndryshuar”</p> <p>308 11.5.22 “Për caktimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si organ përgjegjës për realizimin e procedurës së deratizimit të bimës së gështenjës, me qëllim mbrojtjen e saj nga paraziti grerëza galeformuese (Dryocosmus Kuriphilus Hymenoptera: Cynipidae)”</p> <p>332 18.5.22 “Për përcaktimin e institucionit përgjegjës për mbikëqyrjen dhe kontrollin e prodhimit, importimit, eksportimit, ruajtjes, tregtimit dhe përdorimit të produkteve plehëruese” 333 18.5.22 “Për një ndryshim në vendimin nr.113, datë 17.2.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e dokumentit udhëzues të politikave mbi zonat e përcaktuara për akuakulturë (ZPA) në Shqipëri””</p> <p>418 15.6.22 “Për miratimin e ndryshimit të statusit nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në “tokë urbane”, truall, për sipërfaqen 70.5 m2, pjesë e pasurisë me numër 371/17, zona kadastrale 2259, Bashkia Memaliaj”</p> <p>460 29.6.22 “Për miratimin e Strategjisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit, 2021–2027”</p> <p>556 29.7.22 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.101, datë 9.2.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve që do mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për</p>			
--	---	--	--	--

		bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2022", të ndryshuar"				
45.	5135 prot., datë 10.10.2022	<p>1. Cilat janë kriteret ligjore dhe procedurat që ndiqen për të kryer sigurime të ndryshme sipas nevojave të institucionit tuaj?</p> <p>2. Me cilët operatorë shqiptarë janë realizuar kontratat e sigurimeve të institucionit tuaj gjatë viteve 2017, 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022?</p> <p>3. Cilët lloje sigurime keni realizuar?</p> <p>4. Kërkojmë të na vini në dispozicion një kopje të kontratave për periudhën 2017-2022.</p>	19.10.2022	<p>Në lidhje me pyetjen e parë, MBZHR gjatë një viti kalendarik kryen dy lloje siguracionesh, siguracionet TPL si dhe siguracion të godinës dhe asetëve. Të dyja këto procedura kryhen me procedurë me blerje të vogël, ku sipas ligjit të prokurimeve dhe akteve nënligjore nuk përcaktohen kritere ligjore specifike.</p> <p>Në lidhje me operatorët ekonomik të shpallur fitues, për procedurat e sigurimeve pranë MBZHR-së janë:</p> <p>Për vitin 2017, O.E. Eurosig për siguracionet TPL, ndërsa për sigurimin e godinës O.E. Albsig;</p> <p>Për vitin 2018, O.E. Eurosig për siguracionet TPL dhe për sigurimin e godinës;</p> <p>Për vitin 2019, O.E. Insig për siguracionet TPL, ndërsa për sigurimin e godinës O.E. Albsig;</p> <p>Për vitin 2020, O.E. Insig për siguracionet TPL dhe për sigurimin e godinës;</p> <p>Për vitin 2021, O.E. Insig për siguracionet TPL dhe për sigurimin e godinës;</p> <p>Për vitin 2022, O.E. Insig për siguracionet TPL, ndërsa procedura për sigurimin e godinës nuk është kryer akoma.</p> <p>MBZHR, siç e shpjegoam edhe më sipër, kryhen gjatë vitit kalendarik dy lloje procedurash sigurimi, sigurimet e automjeteve (TPL) si dhe sigurimin e godinës dhe asetëve të saj.Procedurat me blerje të vogël nuk janë të detyrueshme të disponojnë kontratë, pasi polica e sigurimit shërben si kontratë me datat përkatëse.</p>	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0
46.	12.10.2022	A ka një drejtor IT-je ministria? Nëse po më vini në dispozicion të dhënat për drejtorinë përkatëse.	1.11.2022	Me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 88, datë 20.5.2022, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural", është miratuar struktura e MBZHR, (publikuar në faqen zyrtare të internetit të insitucionit	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0

		<p>Nëse jo, ju lutem më vini në dispozicion arsyet pse nuk ka një drejtori të tillë në Ministrinë tuaj? Cilat kanë qenë investimet në sigurinë kibernetike në 5 vitet e fundit?</p>		<p>https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/09/Organigrama.pdf) . Në strukturën e MBZHR aktualisht nuk ka drejtori IT-je apo sektor, pjesë të strukturës së saj.</p> <p>Ky ndryshim në strukturë (mospasje drejtori/sector/specialist te IT pjesë të strukturës), është që nga viti 2017, ne zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.168 date 5.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”. Me parë ishte pjesë përbërëse e Sektorit të Burimeve Njerëzore, IT dhe Redaktimit.</p> <p>Në përgjigje të pyetjes ju lutem referojuni kuadrit ligjor në fuqi:</p> <p>Vendim nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar me vendim nr. 36, datë 24.1.2018, me vendim nr. 448, datë 26.7.2018, me vendim nr. 872, datë 24.12.2019. Urdhrit të Kryeministri nr, 177 date 10.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”. Aktualisht shërbimet e IT -së , në Aparatin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural mbulohen nga Sektori IT (nje përgjegjës dhe një Specialist) të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit të cilët janë të atashuar pranë institucionit tonë.</p> <p>Në lidhje me këtë pyetje lutemi referimin në VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar, ku përcaktohen kompetencat e AKSHI.</p>		
47.	15.10.2022	1. Sa marrëveshje, memorandume dhe protokolle të tilla jane nenshkruar dhe cilat janë ato?	1.11.2022	Gjatë takimeve G2G me palën kosovare janë nënshkruar dhe janë në fuqi këto marrëveshje: a)Protokolli ndërmjet Këshillit të Ministrave të	Përgjigja i është dhënë e	0

		<p>2. Sa prej tyre janë realizuar plotësisht dhe cilat janë?</p> <p>3. Sa prej tyre janë realizuar pjesërisht dhe cilat janë?</p> <p>4. Sa prej tyre nuk kanë nisur ende të realizohen dhe cilat janë?</p>	<p>Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës “Për zbatimin e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunimin në nxitjen dhe lehtësimin e tregtisë”, nënshkruar në vitin 2015;</p> <p>b)Protokolli mbi bashkëpunimin teknik në fushën e bujqësisë ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit rural të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Shqipërisë për njohjen bilaterale të certifikatave fitosanitare veterinare dhe produkteve me origjinë shtazore dhe jo shtazore, nënshkruar me 27 nëntor 2017;</p> <p>c)Protokolli midis Ministrive të Bujqësisë të palëve respektive për njohjen dypalëshe dhe unifikimin e modeleve të certifikatave shëndetësore, veterinare që shoqërojnë kafshët e gjalla dhe produktet me origjinë shtazore, nënshkruar në Pejë, me 26 nëntor 2018. Ky Protokol përfshin edhe objektet e protokolleve të vitit 2015 dhe 2017.</p> <p>d)Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Kosovës, nënshkruar në Elbasan, më 26 nëntor 2021.</p> <p>e)Marrëveshje Bashkëpunimi midis AZHBR dhe AZHB “sipas fushës së bashkëpunimit të përcaktuar në planin e veprimit të Ministrisë së Bujqësisë”, nënshkruar në në muajn qershor 2022 me Qeverinë e Republikës së Kosovës.</p> <p>f)Marrëveshje Bashkëpunimi, “Në fushën e zbatimit të programeve të mbështetjes për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, nënshkruar në mbledhjen e përbashkët të dy qeverive në muajn qershor 2022 me Qeverinë e Republikës së</p>	<p>plotë.</p>
--	--	--	---	---------------

				Kosovës. Në lidhje me pyetjet 2,3 dhe 4 ju bëjmë me dije se të gjitha Marrëveshjet dhe Protokollat e Bashkëpunimit janë në proces zbatimi deri në përfundimin e afatit të përcaktuar nga palët në marrëveshje.		
48.	16.10.2022	Sa është numri i aplikimeve për skemën e re të mbështetjes për mbjelljen e grurit? Sa ka qene sipërfaqja e mbjelle me grure për vitin 2021 dhe a ka të dhëna për 2022?	22.11.2022	AZHBR ka pranuar aplikime online bazuar në udhëzimin Nr. 14, datë 01.08.2022 për masat kombëtare, për masën 7.1 “Mbështetje për kultivimin e grurit”. Këto aplikime u pranuan nga data 1 Shtator 2022 deri në 23 Shtator 2022. Lista e aplikimeve të kualifikuara është e shpallur në faqen zyrtare të AZHBR. Numri i aplikimeve për mbjelljen e grurit gjatë vitit 2022 është 7466 aplikime me sipërfaqe 22 900 75 ha. Skema e mbështetjes së grurit është skemë e financuar për herë të parë në vitin 2022 sipas udhëzimit Nr. 14, datë 01.08.2022. Sipërfaqja e mbjellë me grurë për vitin 2021 ka qenë 54 514 ha. Nga të dhënat e parashikimit të prodhimit për vitin 2022 rezulton se janë mbjellë rreth 54 621 ha. Të dhënat e vitit 2022, nuk janë përfundimtare. Ndërkohë sipërfaqja që pritet të mbillet për vitin 2022 me kulturën e grurit referuar aplikimeve është 22,900.75 ha.	Përgjigja është e plotë.	0
49.	22.10.2022	1. Cilat janë institucionet tuaja të varësisë të cilat paguajnë godina me qera? 2. Sa është hapësira e këtyre godinave? 3. Sa godina të tilla ka secili prej institucioneve? 4. Cila është shuma totale e qerasë së këtyre godinave me dhe pa TVSH? 5. Kur ka nisur kontrata e qerasë?	18.11.2022	Institucionet në varësi të MBZHR që paguajnë godinë me qera janë Drejtoria e Përgjithshme e Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit. <u>Për AKVMB:</u> •Hapësira e godinës me qera të Drejtorisë së Përgjithshme të AKVMB-së është 330 m2. Asnjë nga institucionet e varësisë të AKVMB-së nuk paguan godinë me qera. <u>Për AKU:</u>	Përgjigja është e plotë.	0

				<p>•Drejtoria e Përgjithshme e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, ushtron aktivitetin në ambient me qera në rrugën “Stavri Themeli”, Tiranë (një godinë private) me sipërfaqe 1 032m2 si dhe vende parkimi për automjetet e instiucionit.</p>		
50.	27.10.2022	<ol style="list-style-type: none"> 1. Lista e financimeve të BE-së dhe shpërndarjen sipas granteve dhe kompanive. 2. Financimet e qeverisë shqiptare dhe dhpërndarjen e tyre sipas granteve përkatëse nga vitet 2017-2022. 3. Listën e mbështetjes financiare në agro-turizëm dhe agro-biznes për periudhën 2017-2022. 4. Subvencionet e naftes, shpërndarjen e saj në vitin 2022 dhe kush është fitues i tenderit? 	22.11.2022	<p>Referuar nenit 23 të Marrëveshjes Kuadër, ndërmjet Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Shqipërinë në kuadër të instrumentit për asistencën e para-anëtarësimit (IPA II):</p> <p>d) Strukturat operuese garantojnë informimin e marrësit të asistencës se do të figurojë në listën e publikuar për këtë qëllim. Të dhënat personale që shpallen në këtë listë trajtohen në përputhje me kërkesat e Rregullores (KE) Nr. 45/2001 dhe duke respektuar kërkesat mbi konfidencialitetin dhe sigurinë e të dhënave.</p> <p>Gjithashtu, referuar Nenit 29 “Informimi, publiciteti dhe transparenca” të Marrëveshjes Sektoriale ndërmjet Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian që përcakton dispozitat e menaxhimit dhe zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Republikën e Shqipërisë në kuadër të instrumentit për asistencën e para-anëtarësimit në fushën "Bujqësia dhe Zhvillimi Rural" (IPARD):</p> <p>(1) Shqipëria jep informacion dhe bën publicitet të programit IPARD II dhe të kontributit të BE-së, sipas Shtojcës 8. Grupi i synuar për t’u informuar është publiku i gjerë. Informacioni nënvizon rolin e BE-së dhe garanton transparencë të asistencës së BE-së.</p> <p>(2) Me qëllim që të garantohet transparenca për</p>	Përgjigja është e plotë.	0


			<p>mbështetjen e IPARD, Agjencia IPARD është përgjegjëse për publikimin e listës së operacioneve dhe përfituesve të asistencës IPA II, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 23, pika 2 të MK-së.</p> <p>Publikimi bëhet në format Excel, që mundëson ndarjen, kërkimin, nxjerrjen, krahasimin dhe publikimin e lehtë në internet të të dhënave, për shembull në format CSV apo XML. Lista e operacioneve duhet të gjendet në faqen e internetit apo në portalin e internetit. Informacioni minimal që duhet të përmbajë lista e operacioneve është përcaktuar në Shtojcën 8 të kësaj Marrëveshjeje.</p> <p>Lista e operacioneve që i referohet nenit 29 (3) përmban fushat e të dhënave të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> -emri i përfituesit (vetëm i subjekteve juridike; jo i personave fizikë); -emri i operacionit; -përmbledhje e operacionit; -data e fillimit të operacionit; -data e përfundimit të operacionit (data e parashikuar për përfundimin fizik ose zbatimin e plotë të operacionit); -shpenzimet totale të pranueshme që janë përcaktuar për operacionin; -shkalla e bashkëfinancimit të Bashkimit Evropian, sipas aksit prioritar; -kodi postar i operacionit; ose një indikator tjetër i përshtatshëm për vendndodhjen; -vendi; -emri i kategorisë së ndërhyrjes për operacionin; -data e përditësimit të fundit të listës së operacioneve; <p>Ju lutem gjeni informacionin e kërkuar në linqet e</p>
--	--	--	---

			<p>mëposhtme.</p> <p>http://www.azhbr.gov.al/thirrja-1/</p> <p>http://www.azhbr.gov.al/thirrja-2/</p> <p>http://www.azhbr.gov.al/ipard-3/</p> <p>http://www.azhbr.gov.al/ipard-ii-thirrja-e-katert/</p> <p>1. Financimet e qeverisë shqiptare dhe dhpërndarjen e tyre sipas granteve përkatëse nga vitet 2017-2022.</p> <p>Subjektet përfitues të skemave të financimit nga AZHBR publikohen në faqen tonë zyrtare, web: www.azhbr.gov.al, në të cilën gjeni të dhënat për secilin përfitues, masën e financimit dhe shumën e përfitimit.</p> <p>Ju lutem gjeni informacionin e kërkuar në linqet e mëposhtme.</p> <p>http://www.azhbr.gov.al/skema-kombetare-2017/</p> <p>http://www.azhbr.gov.al/lista-e-fermereve-potenciale-perfitues-bazuar-ne-vkm-dhe-udhezimin-e-ndryshuar/</p> <p>http://www.azhbr.gov.al/skema-kombetare-2019/</p> <p>http://www.azhbr.gov.al/skema-kombetare/</p> <p>http://www.azhbr.gov.al/wp-content/uploads/2022/01/liste-emerore-perfituesve-2021.pdf</p> <p>http://www.azhbr.gov.al/skema-kombetare-2022/</p> <p>2. Listën e mbështetjes financiare në agroturizëm dhe agro-biznes për periudhën 2017-2022.</p> <p>Në linqet e mësipërme janë të përfshirë dhe investimet e kryera sipas viteve dhe me llojin e investimit përkatës.</p> <p>3. Subvencionet e naftes, shpërndarjen e saj</p>		
--	--	--	---	--	--







				<p>në vitin 2022 dhe kush është fitues i tenderit?</p> <p>Në linkun e fundit të skemës kombëtare 2022 gjeni përfituesit e Masës 13 të Mbështetjes me naftë falas për fermerët.</p> <p>Në lidhje me pikën 4 ju informojmë se fitues i procedurës për vitin 2022 ka qenë Bashkimi i Operatorëve Ekonomike “Kastrati” SHPK dhe “Kastrati Group” SHA, për sa i përket subvencionimit dhe shpërndarjes duhet të informoheni në drejtorinë e politikave pranë MBZHR-së dhe për shpërndarjen pranë AZHBR-së.</p>		
51.	31.10.2022	<p>1. Sa ka qenë sipërfaqja e tokës bujqësore në Shqipëri pas ndryshimit të sistemit? (Viti 1991)</p> <p>2. Sa është aktualisht sipërfaqja e tokës bujqësore në vend?</p> <p>3. Cilët janë faktorët që kanë ndikuar më së shumti në reduktimin e sipërfaqes së tokës bujqësore në shkallë vendi?</p> <p>4. Cilët janë qarqet që kanë humbur sipërfaqet më të mëdha të tokës bujqësore dhe sa është kjo sipërfaqe në total?</p> <p>5. Cili ka qenë impakti që kanë pasur ndërtimet e paligjshme mbi tokat bujqësore në këto 30 vite?</p> <p>6. Sa është sipërfaqja e tokës bujqësore që është zënë nga ndërtimet e paligjshme në këto 30 vite?</p> <p>- Sa është sipërfaqja e tokës bujqësore në pronësi private e zënë nga ndërtimet e paligjshme?</p> <p>-Sa është sipërfaqja e tokës bujqësore në pronësi të shtetit e zënë nga ndërtimet e paligjshme?</p>	22.11.2022	<p>1. Sipërfaqja e tokës bujqësore në vitin 1991 gjithsej 697 mijë ha.</p> <p>2. Fondi i tokës bujqësore që figuron aktualisht në regjistrat kadastrale në këtë kategori resursi, është 687 mijë ha gjithsej. Ky fond është aktualisht objekt përditësimi dhe saktësimi, në mënyrë të vecantë për të bërë pasqyrimin në regjistrat kadastral të ndërtimeve informale.</p> <p>3. Faktorët që kanë ndikuar më shumë në zvogëlimin e fondit të tokës bujqësore janë ndërtimet informale, objektet e shërbimit, tregtimit, industriale, energjitike, infrastruktura rrugore si dhe zgjerimi i zonave urbane si pjesë e Planeve të Përgjithshme Vendore.</p> <p>4. Qarqet që kanë humbur sipërfaqen më të madhe të tokës janë: Tiranë, Durrës, Lezhë, Elbasan etj.</p> <p>5. Ndërtimet e paligjshme kanë ndikuar në zvogëlimin e sipërfaqes së tokës bujqësore dhe kanë sjellë pengesa në implementimin e politikave të konsolidimit të tokës bujqësore.</p> <p>6. Ndërtimet e paligjshme në vendin tonë, jo vetëm në tokën bujqësore, kanë qenë objekt i legalizimeve të miratuara sipas Vendimeve të</p>	Përgjigja është dhënë e plotë.	0


		<p>7. Cilat janë qarqet më problematike sa i takon zaptimit të tokës bujqësore nga ndërtimet e paligjshme ?</p> <p>8. Në cilat vite është konstatuar numri më i madh i ndërtimeve të paligjshme mbi toka bujqësore dhe cilat janë shkaqet që fenomeni ka pasur përhapje kaq të gjerë?</p> <p>9. Cilat janë institucionet dhe strukturat përgjegjëse të ngarkuar nga ligji për mbrojtjen e tokës bujqësore dhe a kanë funksionuar ato ndër vite?</p> <p>10. A ka pasur strategji dhe politika në nivel kombëtar ndër vite për të mbrojtur tokën bujqësore nga ndërtimet e paligjshme dhe nëse po në ç masë janë zbatuar ato?</p> <p>11. Sa është sipërfaqja e tokës bujqësore që ka humbur ndër vite Shqipëria si pasojë e përmytjeve, erozionit dhe faktorëve të tjerë natyrorë?</p> <p>12. Cilat zona janë më të rrezikuara nga këto fenomene?</p> <p>13. Sa është vlera e investimeve këto 10 vitet e fundit në funksion të parandalimit të fenomeneve natyrorë që çojnë në degradimin e tokës bujqësore?</p> <p>14. Sa është sipërfaqja e tokës bujqësore që ka humbur Shqipëria si pasojë e ndërtimit të veprave energjitike dhe ato të infrastrukturës publike?</p> <p>15. Në cilat zona kemi humbjen më të madhe të tokës bujqësore si pasojë e ndërtimeve të kësaj natyre?</p>		<p>Keshillit të Ministrave dhe informacion të detajuar mund të siguroni nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës.</p> <p>Procesi i legalizimit vijon edhe tani sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e procesit kalimtar të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”. Per këtë mund të merrni informacion nga ASHK.</p> <p>Ndërkohë nga DAMT-të e qarqeve po vazhdon puna për pasqyrimin e këtyre ndryshimeve në fondin e tokës e tokës bujqësore.</p> <p>7. Qarku Tiranë.</p> <p>8. Gjatë gjithë 30 viteve.</p> <p>9. Autoritetet shtetërore dhe strukturat pranë tyre, të cilat kanë detyrime dhe përgjegjësi për mbrojtjen e tokës bujqësore janë pushteti vendor:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kryetari i bashkisë dhe këshilli i bashkisë; - kryetari i këshillit të qarkut; këshilli i qarkut; <p>Ndërsa në nivel qendror- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Gjithashtu, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në zbatim të ligjit nr.24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”, ndërmer masa për mbrojtjen nga përmytja dhe erozioni të tokave bujqësore nga lumenjtë.</p> <p>10. Ministria e Bujqësisë ka përgatitur ligjin nr.9244. datë 07.06.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore, të ndryshuar në nenin 14, i cili parashikon edhe mbrojtjen e tokës bujqësore nga ndërtimet.</p> <p>11. Studimet e kryera më parë, për këtë problem, dëshmojnë për nivelin e lartë të erozionit të tokës, i cili arrin mesatarisht nga 20 – 70 ton/ha/vit. Gjithashtu sipas vlerësimeve të bërë, rreth 115 000 hektarë</p>		
--	--	---	--	---	--	--


				<p>konsiderohen me rrezik të lartë për rrëshqitjen. Kjo së pari për shkak të terrenit të thyer, por edhe nga dëmtimet e ndodhura në ekosistem.</p> <p>12. Për shkak të formacioneve gjeologjike, konsiderohen më të rrezikuara nga erozioni tokat në boshtin Tepelenë – Përmet – Skrapar – Berat – Elbasan (zona e Krrabës) – Pukë – Mirditë dhe Kukës, etj. Zonat më problematike nga erozioni dhe përmytja janë përgjatë rrjedhës në Ultësirën Perëndimore (kryesisht 30-50 km nga grykëderdhja e lumenjve në det) dhe në grykëderdhje të lumenjve Drin Bunë, Mat, Droje, Ishëm, Erzen, Shkumbin, Devoll, Osum, Seman, Vjose etj</p> <p>13. Në periudhën 2013-2022 janë investuar rreth 5 miliardë lekë në rehabilitimin/ndërtimin e rreth 150 km te argjinaturave të mbrojtjes nga permytja dhe strukturave të mbrojtjes nga erozioni në brigjet e lumenjve, sitemim të shtratit të përrrenjve dhe në argjianturat dhe sistemimet e kanale të ujërave të larta.</p> <p>14. Ky informacion mund të sigurohet rast pas rasti pranë DAMT-ve të cdo qarku ose edhe nga ASHK.</p> <p>15. Humbja më e madhe e tokës bujqësore për shkak të ndërtimeve të infrastrukturës publike evidentohen në zonën e ulët të vendit.</p>		
52.	2.11.2022	1. Një kopje të plotë të kontratës për dhënie me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit, mes Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	18.11.2022	Ne lidhje me piken 5 ju bejme me dije se Në sipërfaqen prej 44.017 ha, e ndodhur në Zonën Kadastrale 2085, e përbërë nga pasuritë nr.54/1, nr.54/7, nr.55/1, nr.55/4, nr.56/1 dhe nr. 57/1 ndodhur në Karavasta e Re, Bashkia Divjakë, Qarku Fier,	Përgjigja është dhënë e plotë.	0

		<p>(Qiradhënësi) dhe Shoqëria Agro Fish Hoti Sh.P.K (Dt. 15. 7. 2020)</p> <p>2. Një kopje të plotë të Planit të Biznesit (Aneksi B), bashkëlidhur kësaj kontrate, si pjesë integrale e saj.</p> <p>3. Dokumentacionin e konkurimit (ofertat, kompanitë pjesëmarrëse, njoftimin për konkurim, shpalljen e fituesit, njoftimet publike në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik, si dhe në mediat kombëtare etj.).</p> <p>4. Hartën kadastrale të ngastrave të dhëna.</p> <p>5. Ju lutem, një përshkrim lidhur me llojin e aktivitetit (bujqësor apo industrial, teknologjitë që do të zbatohen, kulturat që do të zhvillohen) që do të zhvillohet, e përcaktuar në objektin e kontratës; vlera vjetore e qirasë, sipërfaqia e dhënë, si dhe afati i dhënies së tokës me qira.</p>		<p>subjekti “Agro Fish Hoti” shpk, ka planifikuar ndërtimin e një plantacioni me shegë, lajthi, goji berry dhe infrastrukturës mbështetëse në funksion të zhvillimit të aktivitetit bujqësor.</p> <p>Bashkelidhur:</p>  <p>plan-161220220933 ilovepdf_merged.pdf 35_merged.pdf df</p>		
53.	4.11.2022	<p>A mund të përdoret lista e bimëve mjekësore e dërguar në emailin e mëparshëm në çajra dhe infuzione? A mund të përdoren bimë të tjera përveç atyre në këtë listë nëse mund të hahen si ushqim?</p>	10.11.2022	<p>Po, mund të përdoren bimët e listuara në listën që ju kemi vendosur në dispozicion. Cajrat të cilat nuk janë në listë, duhet të regjistrohen paraprakisht sepse kur të përdoren si lëndë e parë duhet të shoqërohen me certifikatë origjine. Duhet mbajtur parasysh gjithmonë kriteret ligjore për etiketimin e produkteve ushqimore.</p>	Përgjigja e dhënë e plotë.	0
54.	4.11.2022	<p>Kërkesë për informim nga ana e institucionit tuaj, lidhur me klasifikimin sipas kategorive (bonitetit) të tokës bujqësore që bëhet nga strukturat e Ministrisë së Bujqësisë, sipas parashikimit të Ligji Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”.</p> <p>Sa më sipër, kërkoj nga ana juaj, në bazë të Ligjit “Për të Drejtën e Informimit” informacion, apo vënien në dispozicion të cdo Urdhëri, Udhëzimi apo VKM mbi klasifikimin sipas kategorisë së tokës</p>	22.11.2022	<p>Kërkesa për informacion lidhur me kategoritë e bonitetit të ngastrave tokë bujqësore duhet t’i drejtohet Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrotjtjes së Tokës, pranë Këshillave të Qarkut ku janë arkivuar gjithë dokumentacioni kadastral, librat e ngastrave, të bonitetit etj, kjo referuar ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrotjtjen e tokës", i ndryshuar, në pikën 1 dhe 4 të nenit 12 citohet që: “1. DAMT-ja mban dhe ruan arkivin me dokumentacionin themelor kadastral, si librat e tokës, librat e ngastrave, planimetritë,</p>	Përgjigja e dhënë e plotë.	0

		<p>bujqësore në Republikën e Shqipërisë, pra cila është ndarja sipas bonitetit të këtyre tokave.</p>		<p><i>hartat kadastrale, topografike dhe dokumente të tjera ekzistuese të arkivit të kadastrës. Në rastet e dëmtimeve fizike të tyre, të shkaktuara nga kohëzgjatja e përdorimit dhe faktorë të tjerë, kjo drejtori merr masa për përtëritjen e tyre, duke siguruar ruajtjen e origjinalit bashkë me kopjen e përtërirë, në mënyrë të përhershme.</i></p> <p><i>4. DAMT-ja kryen shërbime dhe jep informacione në bazë të dokumentacionit që disponon, sipas pikës 1 të këtij neni, për institucione shtetërore, si dhe për persona fizikë dhe juridikë për:</i></p> <p><i>a) madhësinë dhe vendndodhjen e ngastrave bazë kadastrale të tokës bujqësore;</i></p> <p><i>b) statusin juridik mbi pronësinë e tokës për të gjitha zonat kadastrale rurale, ku nuk ka përfunduar regjistrimi fillestar dhe rezultatet e këtij regjistrimi nuk janë marrë në dorëzim nga zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZVRPP).</i></p> <p><i>Për zonat kadastrale rurale, ku është kryer regjistrimi fillestar dhe rezultatet e këtij regjistrimi janë marrë në dorëzim nga ZVRPP-ja, vërtetimet që kërkohen për statusin juridik të pronësisë mbi tokën bujqësore, në cilësinë e pasurisë së paluajtshme, lëshohen nga ky institucion;</i></p> <p><i>c) kategorinë e tokës bujqësore, sipas studimit të bonitetit;”</i></p> <p>2.Nëse në dokumentacion e DAMT-ve mungojnë të dhënat e bonitetit për ngastrat "tokë bujqësore" objekt i kërkese së subjekeve, duhet t'i referoheni procedurave të përcaktuara në pikën 8, 9, kreu V, të VKM nr.121, datë 17.2.2011 “Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komuna dhe/ose bashki”, ku poseduesit e ligjshëm</p>		
--	--	--	--	--	--	--

				të tokës bujqësore sipas përcaktimeve të vendimit të cituar, kryejnë analizat pranë Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë-Krujë.		
55.	9.11.2022	Kopje të Rregullores Nr. 1, datë 27.07.1977 “Për shpalljen Rezervat Natyror i Pishë Poro” e Ministrisë së Bujqësisë.	18.11.2022	Bazuar në nenin 43, shkronja a) e ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” dorëzimi i dokumenteve administrative të institucioneve shtetërore në arkivat përkatës, bëhet pasi të kenë kaluar 10 vjet nga data e krijimit të tyre. Duke qenë se institucioni përgjegjës për zotërimin e këtij informacioni është Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, bazuar në nenin 12, paragrafi i dytë i ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, kjo kërkesë i është deleguar DPA-së,	Deleguar sipas nenit 12 të ligjit 119/2014	0
56.	11.11.2022	Kërkoj të pajisem me dokumentacionin e mëposhtëm: Evidencën përmbledhëse të shtiblerjeve të tokës bujqësore (arë, pemëtoje, vreshta, ullishte) e dorëzuar nga SAMT (Seksioni i Administrimit dhe i Mbrojtjes së Tokës) e këshillit të qarkut Kukës për periudhat vjetore 2013, 2014, 2015.	1.12.2022	Bazuar në nenin 13, të Ligjit Nr. 8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, i ndryshuar, Drejtoria Vendore e Rrethit (ish-ZVRPP-ja), brenda muajit dhjetor të çdo viti i dërgon DAMT-së pasqyrën e transaksioneve të tokës bujqësore dhe DAMT-ja detyrohet që brenda muajit janar të vitit pasardhës të dërgojë përmbledhësen e evidencës në nivel qarku dhe të nënndarjes (rrethit) në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, e cila më pas bën përmbledhësen për të gjithë territorin e vendit. Sa më sipër, bashkëlidhur do të gjeni materialet e përcjella nga DAMT Kukës për vitet 2013, 2014 dhe 2015.	Përgjigja është e plotë.	0
				 shit blerjert 2013 zvrpp has.xlsx  shit blerjert 2013 zvrpp kukes.xlsx  shit blerjert 2013 zvrpp Tropoje.xlsx  shit blerjert 2014 zvrpp has.xlsx  shit blerjert 2014 zvrpp kukes.xlsx  shit blerjert 2014 zvrpp tropoje.xlsx		

				 <p>transaksione kukes.pdf</p> <p>Megjithatë, për të siguruar një informacion zyrtar duhet t'i drejtoheni Drejtorisë Vendore Kukës, Tropojë të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, e cila është institucioni përgjegjës që pasqyron këto transaksione.</p>		
57.	14.11.2022	<p>-Sa është sipërfaqja e tokës së mbjellë në Shqipëri gjatë 2022?</p> <p>-Sa ishte kjo sipërfaqe gjatë 2021 dhe 2020?</p> <p>-Sa është sipërfaqja e tokës bujqësore e lënë djerrë gjatë 2022 në vendin tonë?</p> <p>-Sa ishte kjo sipërfaqe gjatë 2021 dhe 2020?</p> <p>-Cilat janë kulturat që janë mbjellë më shumë gjatë këtij viti?</p>	22.11.2022	<p>Sipërfaqja e tokës së mbjellë për vitin 2022, referuar të dhënave paraprake është në nivele të përafërta me vitin 2021. Të dhëna të sakta dalin në fund të vitit.</p> <p>Për vitin 2021, sipërfaqja totale e kultivuar me bimë arash dhe pemtari rezulton 508,207 ha.</p> <p>Për vitin 2021, sipërfaqja totale e kultivuar me bimë arash dhe pemtari rezulton 508,207 ha.</p> <p>Referuar të dhënave të regjistrave kadastralë, sipërfaqja e tokës bujqësore e kaluar në pronësi private me ligjin 7501 është rreth 560 mijë ha. Diferencat respektive të këtyre sipërfaqeve konsiderohen të pambjella. Megjithatë për ta konsideruar tokën si "djerë" këto sipërfaqe duhet të mos mbillen për të paktën 3 vite radhazi.</p> <p>Referuar të dhënave paraprake (të parashikimit të dytë të prodhimit) rezulton se kulturat që zënë sipërfaqen më të madhe janë: foragjeret, pemët frutore, agrumet, misër, grurë, ullinj, etj.”</p>	Përgjigja është e dhënë e plotë.	0
58.	18.11.2022	<p>1) A janë në dijeni Ministria e Bujqësisë apo edhe instancat e tjera lidhur me gjendjen e rrugës?</p> <p>2) Nëse po, cila është arsyeja që edhe pas këtij projekti, punimet e të cilit kanë përfunduar në vitin 2020, nuk ka pasur ndërhyrje për të rregulluar apo qoftë edhe për të përmirësuar gjendjen e rrugës?</p> <p>3) Kur pritet që të ketë mbështetje për infrastrukturën rrugore në fshatin Tragjas?</p>	14.12.2022	<p>Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ka qenë një ndër 4 ministritë pjesë e projektit. MBZHR ka mbështetur përmes skemave kombëtare agroturizimin dhe turizimin rural në këto fshatra, të cilët kanë aplikuar për mbështetje.</p> <p>MBZHR nuk ka në kompetencë pjesën e infrastrukturës rrugore të fshatrave.</p> <p>Për këtë informacion mund t'i drejtoheni Fondit</p>	Përgjigja është e dhënë e plotë.	0

				Shqiptar të Zhvillimit.		
59.	22.11.2022	<p>1.A janë kryer investime për mbrojtjen nga gërryerja të tokës bujqësore dhe përmbytjet e lumit Drin në Bërdicë (Shkodër)?</p> <p>2.Nëse po, kur janë bërë këto investime?</p> <p>3.Sa ka qenë vlera e investimit?</p> <p>4. Ku është investuar konkretisht dhe çfarë parashikonte investimi?</p>	7.12.2022	<p>Po janë kryer investime për mbrojtjen nga gërryerja e tokës bujqësore dhe zonave të banuara nga lumi Drin, përballë harkut të Bërdicës.</p> <p>Investimi është realizuar në vitin 2021.</p> <p>Vlera e investimit 65 milion lekë.</p> <p>Nëpërmjet këtij investimi është mundësuar ndërtimi i rreth 0.4 km, struktura të mbrojtjes nga gërryerja të tokave bujqësore, nga lumi Drin, në zonën e Bërdicës. Kjo ndërhyrje mbron nga gërryerjet jo vetëm tokën bujqësore por edhe të shtëpive të banimit dhe bizneseve rreth kësaj zone. Struktura mbrojtëse konsiston në veshjen me gurë të bregut dhe ndërtimit të peneleve tërthore po me gurë.</p>	Përgjigja është dhënë e plotë.	0
60.	22.11.2022	<p>1.Cila është sasia e PMB-ve e përdorur 5 vitet e fundit, sipas viteve dhe sipas bashkive, nëse i keni të dhënat të ndara sipas bashkive?</p> <p>2. Raportet e studimeve për prani kimikatesh në tokat bujqësore dhe ujërat që përdoren për ujitje, të 5 viteve të fundit. Nëse nuk janë kryer studime këto 5 vite, cili ka qenë studimi fundit që është kryer, sa të referueshme janë sot përfundimet e tij dhe si e shpjegoni periudhën pa studime të kryera. Keni në plan të kryeni?</p> <p>-Hartën (nëse ekziston) ose listën e tokave të ndotura me kimikate nga bujqësia (produkte plehëruese, pesticide etj.) sipas nivelit të ndotjes.</p> <p>-Ekzistojnë në Shqipëri toka aq të ndotura nga kimikatet bujqësore sa nuk janë të përshtatshme për kultivim? Cilat janë ato? (Bashkangjitur raportin e studimit që e vërteton këtë). Nëse po, si e kontrollon</p>	20.12.2022	 <p>Kthim pergjigje birn Albania.docx</p>	Përgjigja është dhënë e plotë.	0

		<p>MB që qytetarët të mos konsumojnë prodhimin e tyre?</p> <p>3 https://top-channel.tv/2021/09/21/kapen-domate-me-pesticidin-e-ndaluar-u-prodhuan-ne-serat-e-beratit-kamionet-u-refuzuan-nga-nje-vend-i-be/</p> <p>Çfarë komenti keni për lajmin e mësipërm? Cilët janë përgjegjësit? Ju lutem dokumentet e masave të marra ndaj përgjegjësve (masa administrative, kallëzime në prokurori etj.)</p> <p>6. Çfarë ndodh kur sinjalizoheni se një produkt shqiptar në kufi apo në tregjet e huaja kapet me përmbajtje të lartë pesticidesh? Masat e marra 5 vitet e fundit ndaj përgjegjësve (kopje të dokumenteve).</p> <p>7. Rastet kur nga kontrollet në kufi ka rezultuar se produktet me destinacion Shqipërinë ose për riekспорт kanë rezultuar jashtë normave për përmbajtje kimikatesh. Të dhënat e 5 viteve të fundit. Lloji i produktit. Vendi i origjinës. Si keni vepruar</p>				
61.	23.11.2022	<p>1. Sa është numri i fermerëve që kanë aplikuar për të përfituar mbeshtetje për grurin?</p> <p>2. Sa është numri i fermerëve që janë perzgjedhur fitues të skemës së mbeshtetjes së grurit?</p> <p>A ka nisur shpërndarja e parave, nëse jo, kur pritet të nis?</p>	24.11.2022	Deleguar AZHBR në përputhje me nenin 12 të ligjit nr. 119/2014.	Deleguar.	0
62.	25.11.2022	a. Që një varietet rrushi (p.sh. Sheshi i Zi, Sheshi i Bardhë) të emërtohet në etiketë, sa përqindje minimale duhet të përmbajë vera?	20.12.2022	<p>a. Lidhur me kërkesat tuaja, ju bëjmë me dije se ligji “Për Vreshtarinë dhe Verën” është për miratim në komisionet parlamentare.</p> <p>Lidhur me dy pyetjet e para, për verërat cilësore me emërtim të origjinës dhe tregues gjeografik, bazuar</p>	Përgjigja është dhënë e plotë.	0

b. A ka ndonjë kufizim në përdorimin e emrave rajonalë në etiketë (p.sh. rrushi duhet të jetë 85% nga ai rajon)?

c. Në cilat vende eksportohen verërat shqiptare me ndonjë vëllim apo vlerë të njohur?

në ligjin e “Pronësisë industriale”, përcaktohen rregullat përkatëse.

Në bazë të ligjit nr. 9947 datë 7.7.20222 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar, neni 176, pika 7, shkronja b (ii) përcakton se të paktën 85 për qind e rrushit të përdorur për prodhim vjen ekskluzivisht nga zona e tij gjeografike.

Eksporti i verës për vitin 2021 ishte rreth 13.78 ton me një vlerë afërsisht 129.800 euro.

Eksporti i verës dhe vermuth sipas shtetit të eksportuar, 2021:

Shteti	Përshkrimi	Sasia kg	Vlera All	Vlera €
Australia	Wine	41	223,502	1,825.10
Switzerland	Wine and vermouth	2,277	2,469,085	20,162.38
Germany	Wine and vermouth	1,834	2,953,215	24,115.75
French	Wine	12	18,270	149.19
Hungary	Wine and vermouth	57	3,764	30.74
Kenya	Wine	79	80,388	656.44
Montenegro	Wine and vermouth	5,936	2,196,531	17,936.72
Macedonia	Wine	104	121,929	995.66
Portugal	Wine	5	727	5.94
Kosovo	Wine and vermouth	3,434	7,789,163	63,605.77
Total		13,777	15,856,574	129,484